

The background of the entire page is a blue-tinted photograph of a grand, classical building with a prominent dome and a portico supported by columns. In the foreground, several ornate, multi-lamp streetlights are visible, some with decorative finials. The overall scene is captured in a low-angle perspective, emphasizing the height and grandeur of the architecture.

HARTËZIMI I EKSTREMIZMIT ONLINE NË MAQEDONINË E VERIUT

POLITIKA, ETNITË DHE FEJA

RRETH RAPORTIT

Ky raport ofron një linjë fillestare për natyrën dhe shtrirjen e narrativeve ekstremiste, polarizuese dhe të urrejtjes në ekosistemin online të Maqedonisë së Veriut. Raporti ofron një përmbledhje të disa prej narrativeve më të spikatura ekstremiste gjithandej spektrit politik, etnik dhe fetar në vend. Raporti ka për qëllim që qeveritë kombëtare dhe lokale, përfaqësuesit e shoqërisë civile, studiuesit dhe palët e interesuara të sektorit privat të kuptojnë më mirë peizazhin ekstremist në internet, të informojnë politikatat dhe të frymëzojnë kërkime të mëtejshme.

RRETH AUTORIT

Simeon Dukiç është Menaxher i lartë në Rrjetin e qyteteve të forta ku ai drejton programimin në Ballkan dhe Azinë Qendrore. Në Ballkan, ai është i përqendruar në pilotimin e modelit të “Rrjetit për parandalim lokal”, duke udhëzuar iniciativat komunale relevante për rininë dhe duke forcuar koordinimin kombëtar-lokal në parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm. Në Azinë Qendrore ai mbikëqyr zgjerimin e rrjetit. Simeoni më parë ka qenë Bashkëpunëtor projekti pranë Komitetit kombëtar për parandalim të ekstremizmit të dhunshëm dhe luftë kundër terrorizmit të Maqedonisë së Veriut, ku ai mbështeti themelimin e këtij entiteti dhe punoi në hartimin dhe zbatimin e Strategjisë së parë Kombëtare për LEDh dhe Planit për veprim.



Copyright © Institute for Strategic Dialogue (2021). The Strong Cities Network is managed by the Institute for Strategic Dialogue (ISD), a company limited by guarantee, registered office address PO Box 75769, London, SW1P 9ER. ISD is registered in England with company registration number 06581421 and registered charity number 1141069. All Rights Reserved.

MIRËNJOHJE

Do të donim të shprehim falënderimin tonë për ekipin e CASM, duke përfshirë Josh Smith, Francesca Arconzato dhe Shaun Ring për mbështetjen e tyre gjatë gjithë procesit të grumbullimit dhe vlerësimit të të dhënave. Dëshirojmë të falënderojmë gjithashtu Besim Doganin për kontributin e tij të vlefshëm gjatë procesit të konceptimit të hulumtimit; Moustafa Ayad, Kelsey Bjornsgaard, Emir Hasanovic dhe Daniel Hooton për komentet dhe rishikimet e tyre të dobishme; dhe Charlotte Moeyens për mbështetjen e saj gjatë procesit të hartimit dhe publikimit të këtij raporti.

Duhet theksuar se ky studim është shkruar fillimisht në anglisht dhe më pas është përkthyer në maqedonisht dhe shqip. Falënderime të shumta për përkthyesin tonë Nehim Tairi, i cili arriti ta përkthente me sukses këtë studim të ndërlikuar pa ia humbur kuptimin. Së fundi, e falënderojmë Susannah Wight për aftësitë e saj të shkëlqyera të redaktimit dhe Ahmad Tarek për dizajnin e bukur të këtij studimi.

 www.strongcitiesnetwork.org

 info@strongcitiesnetwork.org

 www.twitter.com/Strong_Cities


PËRMBAJTJA

Përmbledhja ekzekutive	01
Gjetjet kryesore	02
Rekomandimet	03
Hyrje	04
Metodologjia	05
Grumbullimi	05
Konsiderata konceptuale	06
Kategorizimi i të dhënave	07
Narrativet	09
Polarizimi politik	09
Urrejtja etnike	15
Ekstremizmi i motivuar nga feja	19
Përfundimi	29
Fusnota	30

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Zhvillimi dhe përhapja e teknologjisë celulare ka krijuar pika të reja qasjeje për grupet ekstremiste për të përforcuar narrativet e tyre dhe për të fituar mbështetje për agjendat e tyre politike. Maqedonia e Veriut nuk bën përjashtim nga ky trend. Platformat e mediave sociale jo vetëm që e kanë bërë më të lehtë për njerëzit që të lidhen me të tjerët, ato gjithashtu e kanë bërë më të lehtë që zërat e urrejtjes të përhapin ideologji ekstremiste. Gjuha e urrejtjes në internet ka qenë një problem i madh në Maqedoninë e Veriut, duke pasqyruar ndarjet e gërshetuara, të përjetuara nga komunitetet e ndryshme. Polarizimi politik i bazuar në përkatësi partiake dhe identitet ka metastazuar me zhvillimet e fundit pas Marrëveshjes së Prespës dhe Revolucionit Laraman. Më tutje, nacionalizmi dhe urrejtja me bazë etnike vazhdojnë të nxisin mosbesimin ndërmjet grupeve të ndryshme etnike që përbëjnë strukturën shoqërore të shtetit.¹ Së fundi, grupet ekstremiste të motivuara nga feja kanë zotëruar përdorimin e hapësirës në internet për të përhapur ideologjitë e tyre ekstremiste dhe për të rekrutuar simpatizues për kauzën e tyre.

Qeveria e Maqedonisë së Veriut dhe organizatat e shoqërisë civile kanë trajtuar urrejtjen dhe ekstremizmin në internet përmes kohezionit social, si dhe parandalimit dhe kundërshtimit të iniciativave të ekstremizmit të dhunshëm (EDh) për më shumë se 20 vjet. Megjithatë Komiteti Kombëtar për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën Kundër Terrorizmit (KKPEDhLKT) u krijua në vitin 2017 për të udhëhequr politikën dhe programimin mbi P/LEDh, çështja e gjuhës së urrejtjes në internet, prej vitesh është trajtuar nga institucione të ndryshme qeveritare, organizata joqeveritare (OJQ) dhe organizatat ndërkombëtare në vend. Si pjesë përbërëse e kësaj përpjekjeje, KKPEDhLKT-ja mori përgjegjësinë, brenda mandatit të tij, të ngrit kapacitetet e palëve të interesuara me qëllim kundërshtimin e kërcënimit të radikalizimit në internet. Edhe pse ka pasur iniciativë të ndryshme me kundër-narrativë në internet për të ndaluar rekrutimin e terroristëve në Maqedoninë e Veriut, deri më sot nuk ka pasur një hartë të detajuar të përmbajtjeve me urrejtje dhe ekstremizëm, si dhe të komuniteteve.



Me qëllim adresimin e këtij hendeku, [Rrjeti i qyteteve të forta](#) (ang. Strong Cities Network) kreu një ushtrim për krijimin e hartës në internet për të hulumtuar narrativet kryesore ekstremiste që përdoren në Maqedoninë e Veriut. Duke zbatuar një metodë të përzier të grumbullimit të automatizuar dhe kërkimit cilësor e manual të ekspertëve në internet, SCN-ja identifikoi narrativet kryesore ndërmjet grupeve politike, etnike, ekstremiste, grupeve të urrejtjes dhe grupeve ekstreme të frymëzuara nga feja. Në bazë të këtyre gjetjeve, SCN-ja ofroi një grup të plotë rekomandimesh për qeverinë, pushtetin vendor, shoqërinë civile dhe sektorin privat të teknologjisë për të ndihmuar në informimin e një përgjigjeje më të plotë ndaj këtyre dëmeve të shkaktuara në internet. Gjetjet e këtij studimi do të njoftojnë edhe për punën e agjencive ndër-sektoriale, të cilën rrjeti po e kryen së bashku me Ekipet për veprim në komunitet në Maqedoninë e Veriut.

GJETJET KRYESORE

- 01** **Hulumtuesit e SCN-së mblodhën rreth 1,290,554 mesazhe në maqedonisht dhe shqip; për rreth 2% (20,670 copë) u zbulua se ishin me përmbajtje polarizuese, urrejtëse dhe ekstremiste në natyrë.** Narrativët polarizues politik në internet ishin më të spikaturat brenda mostrës që përbënin rreth 18,371 copë të përmbajtjes përkatëse; 13.562 mesazhe ishin në gjuhën maqedonase, ndërsa 4.809 në gjuhën shqipe. Pothuajse gjysma e të dhënave në gjuhën maqedonase u gjetën në Twitter (7,025), pasuar nga Facebook (3,263) dhe ueb forume (2,596), ndërsa pjesa më e madhe e përmbajtjes në gjuhën shqipe vinte nga forumet e internetit (4,598).
- 02** **Marrëveshja e Prespës dhe Revolucioni Laraman i vitit 2016 ishin dy temat më të spikatura që nxisnin polarizimin online brenda komunitetit maqedonas.** Të dhënat tregojnë se narrativët e ndërtuar kryesisht rreth një dikotomie binare ‘patriot kundrejt tradhtar’ po zgjerojnë hendeqet e pakalueshme brenda spektrit kryesor politik dhe po krijojnë hapësirë për shfaqjen e lëvizjeve të ekstremit tejet të djathtë, të cilat përbëjnë një kërcënim për stabilitetin afatgjatë kombëtar dhe rajonal.
- 03** **Narrativët që përhapin urrejtje me bazë etnike janë gjithashtu të spikatura në internet me pothuajse 2,300 pjesë të përmbajtjes përkatëse të analizuar.** Këto të dhëna janë mbledhur kryesisht nga Twitter dhe forumet online.
- 04** **Gjuha e urrejtjes mes dy grupeve më të mëdha etnike po lulëzon në mediat sociale pavarësisht mungesës së dhunës në vend që nga konflikti i vitit 2001.** Pjesa më e madhe e narrativëve të spikatur në komunitetin e gjuhës maqedonase sillen rreth kërcënimit të perceptuar të ‘shqiptarizimit’ të Maqedonisë së Veriut i cili karakterizohet me standarde të dyfishta të perceptuara dhe diskriminim të maqedonasve. Përveç kësaj, ata synojnë grupe dhe individë të cilët mendohet se punojnë kundër interesave të popullit maqedonas. Narrativët tregojnë se dikotomia patriot-tradhtar shtrihet në sferën e urrejtjes etnike përmes thjerrzës së ‘anti-maqedonizmit’. Përçarjet midis dy grupeve etnike janë përforcuar në internet dhe duhet bërë më shumë në hapësirën virtuale për të promovuar kohezionin social.
- 05** **Materiale selefiste-xhihadiste me përmbajtje në gjuhën shqipe nga imamë të shquar të lidhur me grupet terroriste janë ende lehtësisht të qasshme në Facebook dhe YouTube.** Një ndër arsyt kryesore që përmbajtja mund të mos jetë hequr është se imamët kanë filluar të përdorin gjuhë që nuk thërret në mënyrë eksplicite për dhunë. Megjithatë, këta imamë ende paraqesin rrezik sepse komentojnë mbi çështje aktuale sociale dhe politike, të cilat mund të interpretohen si thirrje për kapjen e armëve.
- 06** **Përmbajtja e qartë ekstremiste dhe urrejtëse selefiste-xhihadiste është e pranishme edhe në gjuhën shqipe dhe e shpërndarë nëpër grupe të ndryshme.** Për shembull, SCN gjeti dy grupe, ‘Bejtul Muhaxhirin’ dhe ‘Nasheedi im’, të cilët përhapnin propagandë në lidhje me ISIS-in duke bërë thirrje për xhihad. Disa nga përmbajtjet e tyre synonin imamët dhe grupet shqiptare që veprojnë në Maqedoninë e Veriut.
- 07** **SCN gjurmoi praninë në internet të një grupi nacionalist të quajtur ‘Vëllazëria e Krishterë’, i cili kërcënonte kundërshtarët, niste fushata politike, shpërndante dezinformata për COVID-19 dhe realizonte ngjarje humanitare.** Ky grup nacionalist po përdor edhe fenë edhe agjendën e tij politike të krijimit të grupeve “të përfshira” dhe “të përjashtuara” që ngjan me të njëjtën taktikë të imamëve ekstremistë selefiste xhihadiste për të përzier fenë dhe politikën.

REKOMANDIMET

01

KKPEDhLKT dhe Ministria e Brendshme duhet të përmirësojnë të kuptuarit e ekosistemit ekstremist online në Maqedoninë e Veriut. Përveç këtij studimi dhe hulumtimeve të tjera të përqendruara në gjuhën e urrejtjes dhe ekstremizmin në internet në vend, duhet bërë më shumë për të mbikëqyrur vazhdimisht rreziqet dhe kërcënimet në zhvillim. Pa një bazë të duhur të provave dhe të kuptuarit të natyrës së përmbajtjes ekstremiste, qeveria e Maqedonisë së Veriut nuk do të jetë në gjendje të ndërtojë një strategji efikase dhe të fortë të reagimit. Për më tepër, programet e komunikimit strategjik kundër narrativëve ekstremiste nga ana e shoqërisë civile në internet nuk do të jenë në gjendje të mbështesin në mënyrë adekuate grupet e cenushme dhe të luftojnë në mënyrë efektive ideologjitë e urrejtjes. Si rrjedhojë, duhet të bëhen më shumë përpjekje për ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe të shoqërisë civile për të mbikëqyrur hapësirën online në lidhje me përmbajtjet ekstremiste. Resurset duhet të investohen në hulumtime duke përdorur grumbullimin e automatizuar dhe mjetet e përpunimit të gjuhës natyrore për të përpunuar të dhëna më të mira.

02

Qeveria, grupet e shoqërisë civile dhe hulumtuesit duhet të punojnë me platformat e teknologjisë së mediave sociale për të informuar përgjigje të lokalizuara bazuar në gjuhën dhe kontekstin kulturor të Maqedonisë së Veriut. Asnjë nga kompanitë më të mëdha të teknologjisë si Facebook, Twitter dhe Google (YouTube) nuk ka zyra për Ballkanin Perëndimor për të lehtësuar një partneritet të qëndrueshëm me palët e interesuara qeveritare dhe joqeveritare në rajon. Departamenti i Krimit Kibernetik dhe Forenzikës Digjitalë pranë Ministrisë së Brendshme dhe shërbimet e inteligjencës kanë nevojë për forcimin e marrëdhënieve me këto subjekte të sektorit privat në mënyrë që të ndërtojnë reagime të përbashkëta efektive në bashkëpunim me ekspertët dhe organizatat e shoqërisë civile.

03


Heqja dhe censurimi i përmbajtjeve dhe grupeve ekstremiste në internet mund të prishë aktivitetet keqdashëse, por nuk do ta zgjidh problemin pa përmirësuar algoritmet e mediave sociale. Edhe pse kompanitë e mediave sociale kanë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të moderuar përmbajtjen në platformat e tyre, ata kanë përgjegjësi që të përmirësojnë algoritmet e tyre për të ndaluar përdoruesit të hyjnë në 'vrimat ekstremiste të lepujve' përmes përmbajtjes së rekomanduar.

04

Promovimi i shkathtësive të qytetarisë digjitale përmes programeve të edukimit qytetar, pasi ky është çelësi për të luftuar narrativët dhe dezinformatat ekstremiste. T'u japësh individëve njohuri dhe shkathtësi të të menduarit kritik për të vlerësuar përmbajtjen që ata e lexojnë në internet është qasja më efektive për të luftuar mesazhet ekstremiste. Qeveria e Maqedonisë së Veriut mund të punojë drejt këtij qëllimi duke zhvilluar dhe përmirësuar kurrikulat për të pasqyruar nevojën për qëndrueshmëri digjitale, angazhim qytetar dhe bashkëjetesë ndërkulturore, programe të avancuara të trajnimit të mesimdhënësve dhe aktivitete jashtë mesimore.

05

Prezantimi i një qasjeje gjithëpërfshirëse të qeverisë dhe shoqërisë për të trajtuar këtë çështje. Përveç sektorit privat, qeveria duhet të identifikojë dhe forcojë marrëdhëniet me organizatat e shoqërisë civile, hulumtuesit, njësitë e vetëqeverisjes lokale, organizatat fetare dhe grupet rinore për të krijuar kundër-narrativë të fuqishëm dhe efektiv. Besimi në institucionet publike është një problem kryesor në Maqedoninë e Veriut, kështu që zërat dhe mesazhet e sektorit joqeveritar janë të rëndësishme për angazhimin e audiencës së synuar.²



HYRJA

Luftërat që shpërbënë ish-Jugosllavinë socialiste federale dhe periudha sfiduese e tranzicionit demokratik që pasoi, i kanë lënë njerëzit të përçarë, mosbesues ndaj qeverive të tyre dhe të frikësuar për të ardhmen e tyre. Rrjedhimisht, irredentizmi vazhdon të ushqejë tensionet ndëretnike; grupet ekstremiste të motivuara nga feja po depërtojnë në shoqëritë komuniste dikur ateiste,³ ndërsa elitat politike kanë 'kapur shtetin'⁴ për të pasuruar veten dhe rrjetet në kurriz të qytetarëve të tyre. Kjo ka kontribuar në shfaqjen e ekstremizmit, urrejtjes dhe polarizimit në nivel rajonal, kombëtar dhe lokal.

Maqedonia e Veriut është një rast veçanërisht kompleks për hulumtimin e ideologjive të urrejtjes dhe polarizimit. Që nga pavarësia e saj në vitin 1991, vendi pa dalje në det ka pasur një histori të ndërlikuar të karakterizuar me qeverisje të kufizuar demokratike, tensione të armatosura ndëretnike dhe probleme dypalëshe me fqinjët e tij. Të gjitha këto kanë kontribuar në nxitjen e ndasive dhe urrejtjes si brenda ashtu edhe jashtë. Shumë nga këto shfaqje të ekstremizmit dhe urrejtjes do të hulumtohen me hollësi më vonë në këtë raport të politikave.

Përhapja e teknologjive celulare dhe internetit kanë fshirë kufijtë politik dhe kanë krijuar pika të reja të qasjes ku kjo ndjenjë urrejtjeje dhe ideologji ekstremiste mund të përhapet dhe nxitet lirshëm.⁵ E vetmja pengesë e qasjes është bërë gjuha, por meqenëse qytetarët e Maqedonisë së Veriut në përgjithësi i përkasin dy familjeve gjuhësore, maqedonisht (brenda gjuhëve sllave të jugut) dhe shqip, përmbajtja online e synuar për audiencën e Ballkanit Perëndimor në rajon dhe në diasporë konsumohet dhe shpërndahet lehtësisht. Grupet keqdashëse përfitojnë nga kjo qasje e paprecedentë në audiencë pasi ka 80% qasje në internet në Maqedoninë e Veriut;⁶ ata shfrytëzojnë ankesat duke krijuar narrative ekstreme për të polarizuar shoqërinë në kuadër të karakteristikave të veçanta demografike dhe/ose çështjeve politike.⁷

Ky raport mbi politikën do të shpalos paraprakisht çështjet kryesore në Maqedoninë e Veriut lidhur me ekstremizmin në internet, urrejtjen dhe polarizimin. Ai nuk do të përpiqet të adresojë çdo segment të urrejtjes në internet sepse këto çështje janë të shumta; megjithatë, ai do të paraqesë disa nga narrativët kryesor ekstremist, si dhe një pasqyrë të përgjithshme të përmbajtjes polarizuese.

METODOLOGJIA

Grumbullimi

Hulumtimi për këtë raport të politikave kombinoi përpunimin e gjuhës natyrore dhe hetimet manuale me burim të hapur për të mbledhur të dhëna ndërmjet 1 janarit 2019 dhe 15 korrikut 2021. Ai u krye në gjuhën maqedonase dhe shqipe dhe përdori shkrime cirilike dhe latine për të siguruar të dhëna nga të gjitha aspektet e shoqërisë. Të dhënat e mbledhura kishin për qëllim t'iu përgjigjen pyetjeve të mëposhtme kërkimore:

01

Cilat janë narrativët kryesor ekstremist të grupeve gjuhësore maqedonase dhe shqipe në Maqedoninë e Veriut?

Si mund të kategorizohen narrativet ekstremiste?

02

Cili nga narrativet ekstremiste ka pasur më shumë angazhim?

03

Cilat platforma janë më të spikatura për mesazhe ekstremiste dhe urrejtje?

Hapat e rëndësishëm të këtij hulumtimi përfshinin identifikimin e burimeve përkatëse ku individët do të postonin përmbajtje urrejtjeje dhe terma kyç për ekstremizmin në internet, në mënyrë që të mblidhnim të dhëna përkatëse. Hulumtuesit përdorën një listë gjithëpërfshirëse të burimeve për të forcuar cilësinë e gjetjeve:



Platformat e mediave sociale

Twitter⁸
Facebook⁹
YouTube¹⁰



Forume¹¹



Portale lajmesh¹²

Pas grumbullimit të dhënave, hulumtuesit përdorën **251 terma kyç** - 114 në shqip dhe 137 në maqedonisht (alfabeti cirilik dhe latin) - për të filtruar të dhënat më të rëndësishme. Termat kyç u përpiluan brenda vendit duke u bazuar në ekspertizën e personelit, kërkimin në 'desktop' dhe në një 'detektor frazash befasuese', mandej u klasifikuan dhe u strukturuan në tre nën-kategori të përmbajtjeve të urrejtjes: politike/ideologjike, etnike-kombëtare dhe fetare.

Grumbullimi dhe vlerësimi i automatizuar i të dhënave u krye nga instrumenti i përpunimit të gjuhës natyrore 'Method52', i krijuar nga Qendra për analizë të Mediave sociale. Një përshkrim i hollësishëm se si janë përpunuar dhe kategorizuar të dhënat jepet në pjesën "Kategorizimi i të dhënave", më poshtë. Hulumtimi manual ndihmoi për tu dhënë kontekst të dhënave dhe për të identifikuar pikat e verbra ku Method52 nuk mund të hynte lehtësisht në ndërfaqen e programimit të aplikacionit (API). Hulumtimi manual u ndërmor në të njëjtat platforma dhe përfshinte edhe kanalet e Telegramit.

Konsiderata konceptuale

Ky raport i politikave përdor përkufizimin e mëposhtëm për ekstremizmin:

Ekstremizmi është mbrojtja e një sistemi besimi që pretendon epërsinë dhe dominimin e një grupi të bazuar në identitet kundrejt të gjitha 'grupeve të jashtme' dhe propagandon një mentalitet çnjerëzor të 'tjetrit' që është në kundërshtim me pluralizmin dhe të drejtat universale të njeriut. Individët dhe grupet e urrejtjes ndjekin dhe mbrojnë një ndryshim sistematik politik dhe shoqëror që pasqyron botëkuptimin e tyre. Ata mund ta bëjnë këtë nëpërmjet mjeteve jo të dhunshme dhe më delikate, si dhe nëpërmjet mjeteve të dhunshme ose eksplicite.

Çdo 'grup' është unik pasi u siguron pjesëtarëve një sërë karakteristikash, të tilla si përkatësia etnike, besimi fetar, përkatësia racore ose përkatësia politike, të cilat përcaktojnë identitetin e tij/saj. Po aq e rëndësishme, grupi i brendshëm varet nga identifikimi i një grupi të jashtëm, të cilin ai e sheh si një kërcënim ndaj identitetit të tij, objektivave politike dhe mirëqenien e përgjithshme. Kërcënimi (i perceptuar) zakonisht kombinohet me ndjenjën e viktimizimit për të forcuar identitetin kolektiv dhe për të nxitur justifikime për pikëpamje dhe veprime më nënçmuese dhe urrejtëse. Përhapja e përmbajtjeve raciste dhe të ksenofobisë përmes sistemeve kompjuterike është e dënueshme sipas Kodit Penal të Maqedonisë së Veriut, ndërsa dispozitat e tij mbi gjuhën e urrejtjes janë në përputhje me përkufizimin e përdorur për qëllimet e këtij raporti.¹³

Kategorizimi i të dhënave

Duke përdorur softuerin e automatizuar të grumbullimit të të dhënave, Rrjeti i qyteteve të forta (SCN) grumbulloi 3,235,938 copë të përmbajtjeve në të gjitha platformat e synuara, nga të cilat 1,290,554 u grumbulluan duke përdorur fjalë kyçe përkatëse. Shumica e këtyre të dhënave u grumbulluan në forumet e internetit (1,573,000) dhe Twitter (1,486,139). Pothuajse e gjithë përmbajtja që përfshin fjalë kyçe përkatëse u grumbullua nga Twitter, me 1,092,339 pika të dhënash, kryesisht sepse Twitter ofron qasje më të madhe në API-në e tij sesa platformat e tjera.

Përderisa 40% e përmbajtjeve përmbanin fjalë kyçe përkatëse, vetëm 2% (20,670 copë) i përkisnin polarizimit, urrejtjes dhe ekstremizmit në Maqedoninë e Veriut. Të dhënat u filtruan dhe u klasifikuan duke përdorur funksionin klasifikues të Method52, ku etiketimi i përmbajtjes si i rëndësishëm ose i parëndësishëm bazohej në përkufizimin e SCN-së. Ky raport do të përqendrohet në këtë përmbajtje, si dhe në materialin plotësues të grumbulluar përmes kërkimit manual.


Të dhënat u klasifikuan në katër nën-kategori duke përdorur Method52:

- 01 **Gjuha shqipe, politik**
- 02 **Gjuha maqedonase, shkrimi latin, politik (Maqedonisht Latinisht politik)**
- 03 **Gjuha maqedonase, shkrimi cirilik politik (Maqedonisht Cirilik politik)**
- 04 **Gjuha maqedonase, shkrimi cirilik, etnik (Maqedonisht Cirilik etnik).**

SCN-ja u përball me disa kufizime në përdorimin e grumbullimit të automatizuar të të dhënave për këtë hulumtim. Method52 nuk ishte në gjendje të klasifikonte përmbajtjen përkatëse në lidhje me ekstremizmin fetar për shkak të kufizimeve teknike, por kjo nuk do të thotë se ekstremizmi i frymëzuar nga feja nuk është i pranishëm në internet. Për të kompensuar pikat e verbra, SCN-ja grumbulloi të dhëna shtesë në mënyrë manuale. Pjesa "Ekstremizmi i motivuar nga feja", në fund të këtij raporti, ofron një katalog të të dhënave të grumbulluara dhe të analizuara në mënyrë manuale që ofron një pasqyrë të vogël për praninë e grupeve ekstremiste të frymëzuara nga feja që kanë ndikim në internet në Maqedoninë e Veriut.


Gjuha pati një ndikim të dukshëm në grumbullimin e automatizuar. Ngjashmëritë në gjuhët sllave të jugut në të gjithë rajonin e bënë të vështirë grumbullimin dhe filtrimin e përmbajtjeve të shkrimit cirilik maqedonas. Po kështu, shqipja flitet nga popullsia të mëdha në Shqipëri dhe Kosovë, gjë që e bëri më të vështirë izolimin e përmbajtjeve që ishin specifike për Maqedoninë e Veriut. Rrjedhimisht, SCN-ja përfundimisht nuk ishte në gjendje të përpunonte përmbajtje të urrejtjes me bazë etnike në gjuhën cirilike maqedonase ose gjuhën shqipe duke përdorur Method52, ndërsa këto nën-kategori nuk janë përfshirë në klasifikimin automatik të listuar më lart.

Gjuha, gjithashtu i dha peshë shtesë përmbajtjes së shkrimit cirilik maqedonas. Grafiku 1 më poshtë tregon numrin e përmbajtjeve të grumbulluara për secilën nga katër nën-kategoritë. Rritja pas 1 marsit të vitit 2020 pasqyron përfshirjen e të dhënave në Twitter që filloi në fund të marsit 2020. Grafiku 2 paraqet të dhënat e shpërndara sipas platformave. Siç tregojnë këto grafikë, përmbajtja e shkrimit cirilik maqedonas ishte mbizotëruese, por kjo kryesisht për shkak se ishte më e lehta për t'u grumbulluar, filtruar dhe klasifikuar pasi shkrimi është unik për vendin.




Grafiku 01

Vëllimi i të dhënave me kalimin e kohës (VOT) nga 1 janari 2019 - 24 qershori 2020 nga të gjitha klasat e nën-kategorizuara nga SCN-ja



Grafiku 02

Vëllimi i të dhënave me kalimin e kohës (VOT) nga 1 janari 2019 - 24 qershori 2020 nga katër burime në mediat sociale.



NARRATIVËT

Polarizimi politik

Disa informacione të përgjithshme mbi historikun

Gjuha e urrejtjes dhe polarizimi politik kanë qenë gjithmonë një problem alarmant në Maqedoninë e Veriut. Një ndër arsyt kryesore për këtë është se elitat politike kanë kultivuar një sistem të administratës publike të bazuar në klientelizëm përmes të cilit punësojnë mbështetës partiak për të fituar vota gjatë zgjedhjeve.¹⁴ Ky sistem ka politizuar elementë të spikatur të jetës së përditshme dhe ka rritur rëndësinë e përkatësisë politike për shumë njerëz, pasi ekzistenca e këtyre individëve varet nga partia e tyre. Antagonizmi politik vjen edhe nga brenda vetë partive, pasi secila parti promovon fushata për të demonizuar kundërshtarët politik përmes fushatave përçarëse të shpifjeve.¹⁵ Polarizimi dhe armiqësia politike janë aq të përhapura sa presidenti i sapo zgjedhur Stevo Pendarovski ka diskutuar për nevojën e proceseve të pajtimit qytetar.¹⁶

Tensionet e brendshme politike janë përkeqësuar gjithashtu nga mosmarrëveshjet e jashtme politike me Greqinë dhe Bullgarinë rreth komponentëve kryesore të identitetit maqedonas - emri, flamuri, gjuha dhe historia. Këto mosmarrëveshje kanë rritur mosbesimin dhe kanë shkaktuar dikotomi polarizuese të 'patriotëve kundrejt tradhtarëve'. Kjo ndarje shtrihet edhe në çështje të tjera politike dhe sociale në mbarë vendin, duke përfshirë përkatësinë politike dhe sistemin e tij nepotist,¹⁷ refugjatët,¹⁸ komunitetin LGBTQ+¹⁹ dhe BE-në (skepticizmi),²⁰ dhe kanë shkaktuar debate për të përcaktuar se çfarë do të thotë të jesh "maqedonas" dhe si duhet të duket një shtet maqedonas.


Platformat e mediave sociale janë bërë një forum gjithnjë e më i zakonshëm ku elitat politike dhe qytetarët e rregullt kontribuojnë në këto çështje politikisht polarizuese. Bisedat online janë aq të nxehta sa lideri i partisë opozitare 'Levica' (E majta) është thirrur nga Prokuroria Publike e Maqedonisë së Veriut me akuzën për përhapje të gjuhës së urrejtjes në Facebook dhe Twitter.²¹ Megjithëse disa nga këto përmbajtje mund të klasifikohen lehtësisht si gjuhë e urrejtjes, shumë postime problematike jo shprehimisht përmbajnë urrejtje dhe nuk përmbushin pragun e shkeljes së udhëzimeve të komunitetit të platformës për t'i hequr nga atje. Pavarësisht nga etiketa aktuale, këto ndasi tregojnë polarizim dhe antagonizëm serioz në Maqedoninë e Veriut dhe kanë potencial të rriten në ngjarje të dhunshme sikurse sulmi në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin 2017.

Shumica e këtyre fjalëve nuk nxisin urrejtje. Për shembull, dy fjalët kryesore më të përdorura janë emri i vendit dhe VMRO, që i referohet Organizatës sekrete guerile të brendshme revolucionare maqedonase, e cila vepronte në shekujt 19 dhe 20. Organizata ka një trashëgimi të përzier dhe pretendohet nga Maqedonia e Veriut dhe Bullgaria. Aktualisht, termi VMRO përdoret për t’u referuar një partie të qendrës së djathtë Organizata e brendshme revolucionare maqedonase - Partia Demokratike për bashkim kombëtar maqedonas (VMRO-DPMNE) në Maqedoninë e Veriut. Megjithatë, opinionet e shprehura në lidhje me fjalët e renditura në tabelë paraqesin një pasqyrë të një shoqërie të ndarë.



Kurrë Maqedoni e Veriut, vetëm Maqedoni

Maqedonia e Veriut është emri i tretë i vendit të vogël pa dalje në det që gjendet në qendër të Ballkanit. Edhe pse shpalli pavarësinë me emrin Republika e Maqedonisë, vendi u pranua në shumë organizata shumëpalëshe me emrin si Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë (FYROM), një referencë e rënë dakord midis Maqedonisë dhe Greqisë për emrin e shtetit deri në arritjen e një zgjidhjeje përfundimtare.²³ Greqia argumenton se termi “Maqedoni” është pjesë e pandashme e trashëgimisë së saj historike dhe kulturore helene. Si i tillë, përdorimi i tij nga një vend tjetër kërcënon identitetin e Greqisë dhe hap terren për aspirata territoriale për një krahinë të madhe gjeografike në veri të vendit.²⁴ Maqedonia hedh poshtë argumentin e Greqisë për pretendime territoriale dhe nënvizon parimin e vetëvendosjes dhe vetë identifikimit si parësor për identitetin dhe emrin e vendit të saj.²⁵ Pas një ngërçi 27-vjeçar, qeveritë e të dy vendeve arritën një marrëveshje me të cilën vendi u riemërua në Republika e Maqedonisë së Veriut, ndërsa populli i saj vazhdoi të njihet si maqedonas dhe gjuha referohej si maqedonase.²⁶ Pavarësisht lëvdatave ndërkombëtare për zgjidhjen, shumë njerëz ishin të pakënaqur me rezultatin. Kjo ishte e dukshme në terren, me protesta në qytetet kryesore të vendit, si dhe në internet.

Analiza e SCN-së gjeti përmbajtje që tregon polarizim dhe urrejtje midis mbështetësve dhe kundërshtarëve të ndryshimit të emrit. “Северџани/Severxhani” (përkthyer tekstualisht “verioristanët”) u identifikua 874 herë, që është domethënëse në krahasim me fjalët e tjera kyçe, duke marrë parasysh lindjen e tij relativisht të vonshme. Për më tepër, ‘#северџани/#severxhani’ ishte hashtag-u më i përdorur në Twitter me 514 veçori gjatë këtij hulumtimi, siç është portretizuar në cloud, të paraqitur në fotografinë 2.




Kundërshtarët e Marrëveshjes së Prespës, konventës ndërkombëtare që zyrtarizoi ndryshimin e emrit, iu referuan përkrahësve të emrit të ri si 'Severxhani'. Një shpjegim i popullaritetit në rritje të këtij termi është se ai simbolizon lindjen e një shteti të perceptuar të pavlerë dhe të prapambetur e pa identitet. Tweet-et e paraqitura në fotografinë 3 dhe 4 e shfaqin mirë treguesin e ndjenjës ndaj termit Severxhani.




Përderisa ndjenja e urrejtjes ndaj 'Severxhanëve' është evidente në këta dy shembuj, është interesante që Republika e Maqedonisë së Veriut trajtohet si një entitet i veçantë dhe artificial pa asnjë lidhje me Maqedoninë e perceptuar të 'vërtetë'. Megjithatë, pavarësisht këtyre postimeve të urrejtjes dhe indikacioneve të qarta se Severxhani është një term polarizues, ka mendime të ndryshme nëse vetë fjala mund të konsiderohet si gjuhë e urrejtjes. Përderisa disa mendojnë se Severxhani është një shembull tekstual i një termi të përdorur për të çnjerëzuar një grup të caktuar, ndërsa të tjerë e shohin atë si një term të parëndësishëm që pasqyron zhvillimin shoqëror rreth ndryshimit të emrit.²⁷ Pavarësisht nga kjo, nga shembujt e mësipërm është e qartë se termi dhe binarja që ai krijon midis 'patriotëve' dhe 'tradhtarëve' po nxit një ndarje të pakalueshme brenda komunitetit maqedonas. Kjo ka të ngjarë të ndërlikojë përpjekjet për të normalizuar "Maqedoninë e Veriut" si emri kushtetues i vendit dhe do të pengojë stabilitetin në planin afatgjatë.

Ndryshimi i emrit ka shkaktuar lëvizje të tjera që e kritikojnë procesin si errësim të identitetit "real" maqedonas. Për shembull, fushata 'Bojkotoj' (Bojkotiram) synonte t'i bënte qytetarët të kundërshtonin referendumin për emrin në vitin 2018. Edhe pse referendumi ndodhi më shumë se dy vjet më parë, hashtagu '#bojkotiram' u shfaq 116 herë në Twitter gjatë periudhës së grumbullimit të dhënave. Kjo tregon përdorimin e tij të vazhdueshëm pasi terminologjia e fushatës është bërë një shprehje e përgjithshme për rezistencën ndaj Marrëveshjes së Prespës dhe një thirrje për bojkotimin e përpjekjes së qeverisë për të zbatuar regjistrimin në vitin 2021, ndërsa demonstruesit argumentojnë se ai është i manipuluar. Ajo që filloi si fushatë e decentralizuar është shndërruar në Lëvizjen Bojkotoj me ueb faqen e saj, blogun dhe kanalet e saj në YouTube, Twitter, Facebook dhe Telegram, të cilat anëtarët i përdorin për të shpërndarë agjendën e tyre të ekstremit të djathtë (fotografite 5 dhe 6). Është e rëndësishme të vërehet që ky grup nuk përbëhet nga lidhshipi fillestar i fushatës Bojkotoj dhe ka një bazë shumë të vogël mbështetëse.



Fotografia 05

Një fotografi (screenshot) nga ekrani i kanalit Telegram të Lëvizjes Bojkotoj. Në përshkrim thuhet: “#LëvizjaBojkotiram nga populli për popullin #KurrëeVeriut-VetëmMaqedoni”.



Fotografia 06


Një fotografi (screenshot) nga ekrani i kanalit të Lëvizjes Bojkotoj në YouTube me më shumë se 247 mijë shikime dhe 1,38 mijë abonentë. Në ballinë thuhet: “#LëvizjaBojkotiram – Anulimi i Marrëveshjes së Prespës, Marrëveshjes [Miqësisë dhe Bashkëpunimit] me Bullgarinë dhe Platformës së Tiranës [një dokument që perceptohet se çon në “shqiptarizimin” e Maqedonisë].”

NeverNorthOnlyMacedonia (Kurrë Maqedoni e Veriut, por vetëm Maqedoni) shfaqet dukshëm në përshkrimin e kanalit Telegram të Lëvizjes Bojkotoj duke sinjalizuar kundërshtimin e saj ndaj ndryshimit të emrit. Ky hashtag ishte i përhapur gjerësisht në Twitter në kohën e këtij hulmimi dhe përfshihet në hashtag-un e word cloud të paraqitur në fotografinë 2. Kundërshtarët e Marrëveshjes së Prespës gjithashtu e përdorin këtë frazë edhe jashtë internetit, duke e përdorur atë si këngë gjatë ngjarjeve sportive dhe protestave.

Revolucioni laraman



Një tjetër term i spikatur i gjetur gjatë periudhës së grumbullimit së të dhënave ishte “Шарените/Sharenite” (“Laramanët”). Kjo fjalë daton që nga protestat e vitit 2016 në Maqedoninë e Veriut, të njohura gjithashtu si Revolucioni Laraman, i cili rrëzoi qeverinë e udhëhequr nga VMRO-DPMNE e qendrës së djathtë. Protestuesit, të njohur kolektivisht si “Laramanët”, dolën në rrugë pas skandalit tashmë famëkeq të përgjimeve, në të cilin u zbulua se shteti kishte përgjuar në mënyrë të paligjshme më shumë se 20,000 numra telefoni.²⁸ Shumë nacionalistë maqedonas besojnë se Laramanët/Sharenite janë ose mercenarë dhe/ose oportunistë që punojnë në emër të interesave të huaja.

Edhe pse protestat ndodhën pesë vjet më parë, hulmuesit gjetën 1236 përmendje të ‘Laramanëve’. Edhe pse Laramanët dhe ‘Severxhanët’ kanë origjinën në kontekste të ndryshme dhe u referohen grupeve të ndryshme, ata zakonisht klasifikohen së bashku si tradhtarë. “Laramanët” ishin përgjegjës për rënien e qeverisë së mëparshme dhe aktualisht fajësohen për problemet reale duke përfshirë ndryshimin e emrit, korrupsionin dhe federalizimin e ardhshëm të perceptuar. Postimet në Tweeter të paraqitura në fotografinë 7 deri në 9 tregojnë se si akuzohen ‘Laramanët’ për atë se kanë standarde të dyfishta në reagimet e tyre ndaj skandaleve të perceptuara që përfshijnë qeverinë aktuale dhe të mëparshme. Postimet duket se janë të orkestruara me një qëllim për të delegjitimuar ‘Laramanët’ dhe rezultatin e Revolucionit Laraman. Madje, një nga postimet tërheq paralele mes ‘Laramanëve’ dhe ‘Severxhanëve’ si grupe të ngjashme tradhtarësh.



Fotografia 07

Një fotografi (screenshot) i një postimi ku thuhet: “Ata e dënuan vrasësin e Martin Neshkovskit me 14 vjet burg. Përkundër kësaj, Laramanët dhe komunistët [term nënçmues për komunistët] dogjën Shkupin. Vrasësi i 17-vjeçarit nga Novo Lisice dënohet sot me 3 vite burg. Të njëjtit komunistë dhe laramanë nuk po e ngritin zërin. Ua kanë mbyllur gojën me para.”



Personi që poston tweet-in e paraqitur në fotografinë 7 akuzon se Laramanët u heshtën me pagesa për të mos iu përgjigjur padrejtësive të perceptuara. Gjatë protestave të vitit 2016, ata u implikuan në një komplot më të gjerë kundër shtetit të financuar nga filantropi George Soros.²⁹ Kjo lidhje është një shpjegim përse ‘Soros’ u identifikua 509 herë si një fjalë kyçe përkatëse. Individët që ishin pjesë e komplotit të Sorosit quheshin Sorosoidë dhe janë gjithashtu pjesë e klubit më të gjerë të tradhtarëve. Trashëgimia e konspiracionit Soros vazhdon të jetojë përmes terminologjisë që shumë individë përdorin për të etiketuar të tjerët si tradhtarë të komunitetit maqedonas.

Diskursi politik shqiptar

SCN-ja nuk identifikoi ndonjë përmbajtje politikiisht polarizuese në shqip përtej dallimeve ndërmjet fraksioneve politike kundërshtarë. Kjo ka ndodhur mbase për shkak të kufizimeve të grumbullimit të të dhënave me të cilat u përball SCN-ja gjatë grumbullimit të përmbajtjes në gjuhën shqipe. Hulumtuesit nuk ishin në gjendje të filtronin përmbajtje politike nga Shqipëria dhe Kosova që nuk lidheshin drejtpërdrejt me Maqedoninë e Veriut. Rrjedhimisht, SCN-ja nuk ishte në gjendje të grumbullonte të dhëna nga forumet e jashtme të internetit. Fotografia 10 paraqet fjalët kyçe më të përhapura sipas klasifikuesit politik shqiptar.



Urrejtja etnike

Disa informacione të përgjithshme mbi historikun

Që nga pavarësia e Maqedonisë së Veriut ka pasur tensione etnike në mënyrë të përsëritur. Kjo ka qenë më e dukshme ndërmjet dy grupeve më të mëdha etnike në vend – maqedonasit dhe shqiptarët. Në vitet e '90-ta, tensionet shpërthyen në përleshje të dhunshme ndërmjet policisë maqedonase dhe demonstruesve shqiptarë, më së shumti me të shtënat në Bit Pazar në Shkup në vitin 1992 dhe trazirat në Gostivar dhe Tetovë në vitin 1997.³⁰ Këto ngjarje e arritën kulmin me konfliktin e vitit 2001 ndërmjet forcave të sigurimit shtetëror dhe Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare Shqiptare (UÇK), ndërsa ky konflikt përfundoi me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit.³¹ Megjithëse nuk ka pasur armiqësi të dhunshme mes dy grupeve gjatë 15 viteve të fundit, përveç disa incidenteve të izoluara, tensionet dhe urrejtja nuk janë zhdukur. Një arsye për mungesën e dhunës është se anëtarët e dy etnive kanë funksionuar në masë të madhe brenda komuniteteve të tyre dhe kanë bashkëjetuar paralelisht me ndërveprim të kufizuar pavarësisht ekzistimit të programeve për promovimin e kohezionit social. Megjithatë, armiqësia dhe antagonizmi midis dy grupeve është ende i përhapur në internet.³²

Është e rëndësishme të theksohet se gjuha e urrejtjes me bazë etnike në vend nuk është ekskluzivisht ndërmjet maqedonasve dhe shqiptarëve; ajo ka prekur të gjitha komunitetet që përbëjnë shoqërinë multikulturore të Maqedonisë së Veriut, duke përfshirë romët, turqit, serbët, boshnjakët dhe të tjerët. Për më tepër, ka gjuhë të urrejtjes drejtuar kombeve fqinje. Së fundmi, ka pasur një rritje të përmbajtjes anti-bullgare në internet për shkak të çështjeve të vazhdueshme dypalëshe midis Maqedonisë së Veriut dhe Bullgarisë. Për shembull, një media bullgare identifikoi një grup publik në Facebook të quajtur "Le të pështyjmë bullgarët dhe simpatizantët bullgarë", ku anëtarët postojnë komente urrejtëse dhe mbrojnë përdorimin e dhunës fizike kundër turistëve bullgarë dhe bullgarofilëve.³³


Gjetjet e përgjithshme

SCN-ja identifikoi 2,299 copë të përmbajtjes përkatëse në lidhje me urrejtjen etnike. Të gjitha të dhënat e klasifikuara nga SCN-ja ishin me alfabet cirilik maqedonas. SCN-ja grumbulloi të dhëna në gjuhën shqipe dhe alfabetin latin maqedonas; megjithatë, nuk ishte e mundur të klasifikoheshin në mënyrë të qëndrueshme kryesisht për shkak të kufizimeve në grumbullimin e automatizuar të përmendur më parë. Për shembull, SCN-ja identifikoi postime që u grumbulluan në gjuhën shqipe drejtuar serbëve sepse termat nënçmues që ata përdornin janë të njëjta me ato të përdorura ndaj maqedonasve. Veçantia e alfabetit cirilik maqedonas bëri të mundur filtrimin e të gjithë përmbajtjes polarizuese etnike që ishte e parëndësishme për Maqedoninë e Veriut. Kjo nuk nënkupton që urrejtja me bazë etnike në internet nuk është e pranishme në Maqedoninë e Veriut në këtë alfabet; dhe në vend të kësaj, SCN-ja vendosi të mos prezantojë të dhënat e gjuhës shqipe dhe shkrimit latin maqedonas për shkak të saktësisë së ulët të klasifikuesve të saj.

Pjesa dërmuese e postimeve përkatëse të urrejtjes etnike u grumbulluan nga Twitter (1,066) ose nga ueb forumet (932). Facebook-u ka një shkallë më të lartë depërtimi në Maqedoninë e Veriut sesa Twitter, por kufizimet në qasjen e API-së së tij e bënë më të vështirë qasjen në të dhëna për hulumtuesit. Tabela 2 dhe Fotografia 11 tregojnë fjalët kyçe më të spikatura nga postimet përkatëse që paraqesin urrejtje të motivuar etnikisht.

Numri	Fjala kyçe	Numri (vazhdon)	Fjala kyçe
685	Maqedonia	94	Kosova
539	UÇK	93	Para
430	Shiptar	91	Cigan
260	Maqedonas	90	Shtet
199	Maqedonas	79	Mbrojtësit e Maqedonisë
134	Ciganët (Gypsies)	50	Shqipëri e Madhe
111	Popujt	34	Në 2001
108	Shqiptarët	34	Rikthimi i vendit tonë
97	Ballistët	28	Për Kryeministër

Tabela 02 Fjalët kyçe më të përdorura sipas klasifikuesit etnik cirilik maqedonas




Pesë fjalët kryesore në listë përfshijnë tre referenca për Maqedoninë dhe qytetarët e saj, si dhe një term nënçmues për shqiptarët ('Shiptar') dhe akronimin shqip për Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare (UÇK). Lista përmban gjithashtu një term tjetër nënçmues për shqiptarët (ballistët) dhe referenca për Shqipërinë e Madhe, një kërcënim i rëndësishëm i perceptuar midis disa anëtarëve të grupit etnik maqedonas. Përveç fjalëve kyçe të urrejtjes në adresë të shqiptarëve, lista përmban fjalën 'Cigan' (dhe Ciganët), që përdoret zakonisht për të tallur komunitetin rom. Interesant është fakti se termat nënçmuese të drejtuara ndaj grupeve të tjera etnike si bullgarët, serbët, boshnjakët dhe turqit nuk hynë në listë, edhe pse ka pasur raste të regjistruara të gjuhës së urrejtjes edhe ndaj këtyre grupeve.

Është e rëndësishme të theksohet se të dhënat e paraqitura këtu janë marrë nga një mostër e vogël e përmbajtjes me urrejtje të grumbulluar dhe klasifikuar në mënyrë të automatizuar dhe në asnjë mënyrë nuk përfaqëson ekosistemin më të gjerë të urrejtjes etnike në internet.

'Antimaqedonizmi'


Hulumtimi i SCN-së zbuloi se pjesa dërmuese e urrejtjes me bazë etnike i ka rrënjët nga një kërcënim i perceptuar për shtetin dhe popullin maqedonas. Kërcënimi perceptohet të shfaqet në mënyra të ndryshme; për shembull, standarde të dyfishta për maqedonasit etnik dhe grupet e tjera në vend, privilegje për jo maqedonasit – veçanërisht grupet që janë kthyer kundër shtetit, si dhe një prani e shtuar e elementëve të perceptuar jo maqedonas në shoqërinë kryesore. Segmentet ekstreme brenda komunitetit etnik maqedonas i perceptojnë shqiptarët si kërcënimin kryesor ndaj shtetit. Ka shumë narrative të përkrahura nga ato segmente që synojnë të nxisin antagonizëm të mëtejshëm ndaj shqiptarëve. Dy më të spikaturat janë krijimi i të ashtuquajturës Shqipëri e Madhe, e cila shihet si një kërcënim i drejtpërdrejtë ndaj integritetit territorial të Maqedonisë së Veriut dhe zbatimi i Platformës së Tiranës, e cila shihet si një mjet për federalizimin dhe 'shqiptarizimin' e Maqedonisë së Veriut. Termi "Shqipëria e Madhe" u shfaq 50 herë në kampionin përkatës, ndërsa termi "Rikthimi i vendit tonë" dhe hashtag-u "#federalizim" u shfaqën 34 dhe 25 herë veç e veç.³⁴

Ekzistojnë dy ndarje shtesë që krijojnë përçarje dhe mosbesim midis dy grupeve etnike. Gjuha maqedonase dhe ajo shqipe janë krejtësisht të ndryshme dhe përderisa shumica e shqiptarëve mund të kuptojnë dhe flasin gjuhën maqedonase, shumica e maqedonasve nuk mund ta kuptojnë gjuhën shqipe. Miratimi i gjuhës shqipe si gjuhë e dytë zyrtare në të gjithë territorin e Maqedonisë së Veriut u pa si një hap tjetër drejt 'shqiptarizimit' të vendit dhe u prit me protesta.³⁵ Më tutje, ka dallime fetare midis maqedonasve dhe shqiptarëve. Shumica e maqedonasve janë të krishterë ortodoksë, ndërsa shumica e shqiptarëve janë myslimanë.³⁶ Identiteti i myslimanëve shqiptarë shihet si një çështje tjetër që kërcënon vlerat e krishtera maqedonase. Disa nga tweet-et më të pëlqyera dhe të shpërndara të paraqitura në fotografitë 12 deri 14 e demonstrojnë këtë antagonizëm në praktikë.




Fotografia 12

Një fotografi (screenshot) i një postimi ku thuhet: "Maqedonasit nuk kanë më durim! Është koha të rikthejmë vendin tonë! Terroristët e UÇK-së dhe myslimanët nuk do të luajnë më lojëra me Maqedoninë ortodokse! Mijaft më! E kërkuat vetë – TANI SHIJOJENI."



Fotografia 13

Një 'screenshot' i një postimi ku thuhet: "FFM [Federata e Futbollit të Maqedonisë] e pezullon Vardarin [klubin etnik maqedonas] nga liga maqedonase, në mënyrë që Shkëndija [klubi etnik shqiptar] të mund të kualifikohet në Ligën e Evropës. Ministria e Kulturës sponsorizon një libër për Shqipërinë e Madhe. Ministri i Mbrojtjes po fotografohet me simbole të UÇK-së. Qeveria ndalon festimin e Ditës së Shpirtrave, por lejon Bajramin. Ka subvencione për synet, por jo për pagëzime."



Fotografia 14

Një 'screenshot' i një postimi ku thuhet: "Për temën e një 'Shiptari' për kryeministër, qysh vitin e kaluar bisedohej mes qarqeve të LSDM-së [Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë]. Mos dëgjoni çfarë thotë Zaevi sepse gënjen. Epo, të dashurit e mi, koburen duhet ta mbajmë për çdo rast. Ne jemi popull frikacak! Frikacak."

Megjithatë, një pjesë e konsiderueshme e të dhënave të SCN-së analizozi “tradhtarët” e lidërshipt politik maqedonas, të cilët perceptohen se i shpijnë përpara interesat shqiptare, të cilat konsiderohen si antimaqedonas. Për shembull, SCN-ja gjeti një grup abuziv Tweet-esh në adresë të Ministres së Mbrojtjes. Përmbajtja e urrejtjes ishte si përgjigje ndaj një fotografie që ajo shkrepri me kryetarin e Kërçovës, një qytet në Maqedoninë perëndimore, në të cilën logoja e UÇK-së dukej në pjesën e pasme të kabinetit të kryetarit.

May 31, 2020

После секое ваше сликање пред обележја на УЧК сетете се дека некој сеуште плаче за своето чедо загубено во борбите со тогашната паравоена формација УЧК за време кризата 2001 година
Foto:Google.com



12 62 203

Fotografia 15 Një 'screenshot' i një postimi ku thuhet: “Pas çdo fotografie që bëni me simbolet e UÇK-së, mbani mend se disa njerëz ende qajnë për humbjen e fëmijëve të tyre në betejat me njësinë e atëherëshme paraushtarake të UÇK-së gjatë krizës së vitit 2001.”

May 29, 2020

Министер за одбрана на Македонија се слика пред амблеми на УЧК, оние кои убиваа македонски војници.
Мизерно.
Жално.
Тажно.
Војската треба и откаже послушност на ова створење!
Нека си бара гласови од УЧК.



Fotografia 16 Një 'screenshot' i një postimi ku thuhet: “Ministrja e Mbrojtjes së Maqedonisë po bën fotografi para stemave të UÇK-së, të njëjtat që vranë ushtarët maqedonas. E mjerë. E dhimbshme. E trishtuar. Ushtria duhet të mos i bindet urdhrave të kësaj sajese. Ajo duhet të kërkojë vota nga UÇK-ja”. Fotoja është nga Ministri i Mbrojtjes dhe Kryetari i Komunës së Kërçovës.

Jun 3, 2020

Сликањето на Шекеринска пред симболите на УЧК не е случајно. Не само што не е случајно туку тоа е и ВИСОКОСИМБОЛИЧНО. Таа е застаната во воената поза „PARADE REST” на УЧК, преземена од американската војска. Тоа е поздравна парадна поза која укажува почит



Fotografia 17 Një 'screenshot' i një postimi ku thuhet: “Fotografia e Shekerinskës [Ministres së Mbrojtjes] përballë simboleve të UÇK-së nuk është e rastësishme. Jo vetëm që nuk është e rastësishme, por është SHUMË SIMBOLIKE. Ajo qëndron në pozicionin ushtarak 'Parade Rest' të UÇK-së, e cila është përvetësuar nga Ushtria Amerikane. Është një qëndrim përshëndetje që shpreh respekt.”

Konflikti civil i vitit 2001 la shumë pjesë të popullsisë, maqedonase dhe shqiptare të shkatërruar dhe të traumatizuar dhe u shoqërua me një proces të gjatë të drejtësisë tranzicionale dhe pajtimit, i cili zgjat deri më sot. Përderisa për disa shqiptarë UÇK-ja është simbol i rezistencës dhe lirisë, për disa maqedonas ende shihet si një grup paraushtarak terrorist që u rebelua kundër shtetit. Prandaj, reagimet ndaj fotografisë nuk janë befusuese duke pasur parasysh simbolet e diskutueshme të UÇK-së të pranishme në kabinetin e kryetarit të Kërçovës dhe mungesën e procesit të pajtimit për luftën e armatosur të vitit 2001 (shih fotografitë 15 deri 17). Grupi i fjalëve (online cloud) e këtyre ngjarjeve tregon dy gjëra të rëndësishme: dikotominë 'patriot kundrejt tradhtar' që shtrihet në sferën e urrejtjes etnike përmes thjerrëzave të 'anti-maqedonizmit', si dhe përçarjet midis dy grupeve etnike që janë përforcuar në internet dhe duhet të bëhen më shumë përpjekje në hapësirën virtuale për të promovuar kohezionin social.

Ekstremizmi i motivuar nga feja

Historiku

Maqedonia e Veriut është një shtet shumë-fetar dhe ka përjetuar shumë raste të urrejtjes dhe ekstremizmit me bazë fetare gjatë viteve. Feja ka luajtur një rol të rëndësishëm gjatë historisë së rajonit, duke ndihmuar në formimin e strukturës shoqërore të komuniteteve të ndryshme të tij. Edhe kur vendi ishte pjesë e Federatës Socialiste Jugosllave,³⁷ feja luajti një rol të rëndësishëm në forcimin e identitetit maqedonas përmes krijimit të një kisha të veçantë ortodokse maqedonase në vitin 1967, autoqefalia e së cilës sfidohet edhe sot e kësaj dite.³⁸

Pas rënies së Jugosllavisë, rajoni përjetoj një ringjallje të fesë dhe shpirtërores. Kjo dukuri u shfaq në mënyra të ndryshme dhe mungesa e një reagimi strategjik të qeverisë hapi derën që grupet keqdashëse fetare të përhapen në të gjithë rajonin. Maqedonia e Veriut nuk ishte përjashtim nga ky trend i cili u karakterizua me shfaqjen e rrjeteve selefiste-xhihadiste në njërin anë dhe sinergjisë së etno-nacionalistëve të krishterë në anën tjetër.

Një vështrim i përgjithshëm i komunitetit selefiste-xhihadist

Muslimanët në territorin e Maqedonisë së Veriut kanë qenë historikisht pjesë e shkollës tradicionale hanefite, që daton që nga sundimi i osmanëve kur Islami u përhap në rajon. Megjithatë, variacionet e selefizmit dhe vehabizmit filluan të përhapen në vend pas pavarësisë së RMV-së të mbështetur nga një influks i paligjshëm i mjeteve financiare nga Arabia Saudite dhe Shtetet e Gjirit.³⁹ Me këtë gjë, edhe ndikimi i grupeve militante selefiste-xhihadiste u rrit dukshëm. Për shembull, një njësi muxhahidinësh i quajtur Imran Elezi ishte përfshirë në mënyrë aktive në konfliktin e vitit 2001; një grup ekstremist keqtrajtoi në mënyrë aktive komunitetet shi'ite dhe bektashiane, ndërsa predikuesit radikal filluan të merrnin kontrollin e xhamive nga Bashkësia fetare islame, një organizatë e pavarur fetare e myslimanëve e udhëhequr nga Reis-ul-ulema⁴⁰ i vendit. Po aq e rëndësishme, imamët selefist-xhihadist gjithashtu po rekrutonin anëtarë për t'u bashkuar me grupet e njohura terroriste, duke përfshirë Al-Kaedën dhe degët e saj, si dhe Shtetin Islamik. Vlerësohet se më shumë se 150 shtetas të Maqedonisë së Veriut, kryesisht burra, u larguan për t'u bashkuar me radhët e Shtetit Islamik të Irakut dhe Sirisë (ISIS) dhe Hayat Tahrir al-Sham (HTS), si dhe filialeve të tij në Siri dhe Irak,⁴¹ ndërsa Abdul Jashari, një shqiptar etnik i lindur në Shkup, u bë i njohur në hierarkinë ushtarake të Jabhat al-Nusra (aktualisht HTS), i cili e detyroi Departamentin e Thesarit të Shteteve të Bashkuara ta fus atë në listën e sanksioneve për terrorizëm.⁴² Spekullohet se ai aktualisht drejton një divizion snajperistësh shqiptarë të quajtur Xhemati Alban, i cili vepron në Idlib të Sirisë, nën ombrellën e HTS.⁴³

SCN-ja ishte më pak e suksesshme në grumbullimin dhe analizimin e të dhënave të lidhura me përmbajtjen Selefiste-xhihadiste përmes mjeteve të përpunimit të gjuhës natyrore sesa në grumbullimin e të dhënave për dy temat e tjera të vlerësuara më sipër. Shumica e të dhënave të grumbulluara përfshinin diskurs teologjik jo të dhunshëm dhe raportime mbi konfliktin në Siri dhe Irak. Ka disa arsye të mundshme për këtë gjë: sigurimi i fjalëve kyçe dhe burimeve jo specifike; propaganduesit dhe grupet ekstremiste nga Maqedonia e Veriut u hoqën nga platformat e mediave online; propaganduesit dhe grupet ekstremiste i kanë zhvendosur komunikimet e tyre në grupe të mbyllura të koduara si rezultat i masave më të plota të mbikëqyrjes nga autoritetet; ose propaganduesit ekstremistë i kanë përshtatur mesazhet e tyre në mënyrë që të mos përbëjnë gjuhë të urrejtjes dhe të shmangin mbikëqyrësit në internet.

Meqenëse indeksimi i automatizuar nuk ishte në gjendje të siguronte një sasi të konsiderueshme të dhënash të dobishme përkatëse, SCN-ja kreu hulumtime manuale me burim të hapur të përmbajtjeve ekstremiste të motivuara nga feja.

Imamët ekstremistë

Ky hulumentim zbuloi se ka gjurmë të përmbajtjes në lidhje me ekstremizmin publikisht të qasur në internet, por shumica e grupeve aktualisht janë joaktive. Pavarësisht pasivitetit të tyre, të dhënat e lidhura me predikuesit e njohur ekstremistë janë vetëm një kërkim larg në Google për këdo që është i interesuar për këtë përmbajtje. SCN-ja gjeti një llogari të 'fjetur' në Facebook dhe YouTube të lidhur me imamin ekstremist Rexhep Memishi. Ai u dënua me shtatë vjet burg si pjesë e çështjes policore 'Qelia 1' në vitin 2016 për rekrutimin e individëve për pjesëmarrje në luftëra të huaja dhe/ose në njësi (para)ushtarake. Faqja në Facebook 'Minberi i Teuhidit' (përkthyer nga shqipja në 'Nxënësi i Teuhidit') në lidhje me imamin radikal ka 50,147 pëlqime dhe 49,622 ndjekës (Fotografia 18). Faqja publike ka qenë joaktive që nga data 7 shkurt 2019 kur u postua një video e Memishit duke mbajtur një ligjëratë mbi rëndësinë e dashurisë ndaj Allahut për të arritur kuptimin. Ekuivalenti në YouTube i faqes me titull 'Minberimedia' është aktiv që nga qershori i vitit 2012 dhe ka grumbulluar gati 13 milionë shikime nga 382 video, kryesisht në gjuhën shqipe (Fotografia 19). Ngjashëm me faqen në Facebook, kanali nuk ka publikuar përmbajtje të reja që nga janari i vitit 2018. Është e rëndësishme të theksohet se këto llogari ishin aktive në fillim të vuajtjes së dënimit me burg të Memishit, që në vitin 2017.


Në vitin 2016, Analytica, një 'think-tank' nga Shkupi, identifikoi disa video problematike ku Memishi bën thirrje për martirizim në mbrojtje të kufijve të një Shteti Islamik (duke mos iu referuar kalifatit) dhe duke inkurajuar besimtarët të shpërngulen në Siri.⁴⁵ Gjatë këtij hulumentimi, SCN-ja identifikoi dy video shtesë në këtë platformë ku Memishi etiketon myslimanët në Maqedoninë e Veriut që ndjekin praktikat tradicionale Hanefite si kafirë (jobesimtarë). Pesë vjet më vonë, videot janë ende në internet.

Në sipërfaqe, përmbajtja e Memishit thjesht inkurajon përkushtimin ndaj Islamit, kërkimin e arsimimit dhe jetesën modeste, ndërsa videot që përmbajnë përmbajtje shprehimisht ekstremiste ishin të rralla. Për shembull, videoja më e shikuar në faqen e YouTube e lidhur me të - me më shumë se 11 milionë shikime - ishte një këngë për mbrojtjen dhe përqaftimin e jetimëve si pjesë e umetit mysliman. Megjithatë, pas një inspektimi më të afërt, përmbajtja e tij shërben si propagandë që përcakton grupet e brendshme dhe të jashtme, si dhe mbështetet në një narrativ të islamit ekstremist që ishte shumë i rëndësishëm për përpjekjet e tij të rekrutimit. Rrjedhimisht, përmbajtja e tij është e vështirë të etiketohet në mënyrë eksplicite si "ekstremiste" dhe për këtë arsye është më e vështirë për t'u hequr. Kjo mund të shpjegojë pse është ende e qasshme publikisht pavarësisht dënimit të tij për rekrutim terrorist. Megjithatë, pavarësisht karakterit të saj të moderuar, kjo platformë duhet të hiqet nga mediat sociale sepse është e ndërlidhur me një predikues ekstremist që shërben për rekrutimin e individëve për t'iu bashkuar ISIS-it dhe grupeve të ndërlidhura me Al-Kaedën.



Fotografia 18

Një 'screenshot' i faqes së Facebook-ut në lidhje me Memishin



Fotografia 19

Një 'screenshot' i Kanalit të YouTube në lidhje me Memishin

Ky hulumtim identifikoi imamë të tjerë të dyshuar radikalë me një prani të dukshme në mediat sociale. Bekir Halimi është një imam me lidhje të dyshuara me organizatat terroriste selefiste-xhihadiste.⁴⁶ I trajnuar në Jordani, ai ishte kreu i një shoqate bamirësie të quajtur Bamiresija, e cila ishte nën hetim për pastrim parash dhe financim të terrorizmit. Sipas kablllogrameve diplomatike të ShBA, të marra përmes Wikileaks, organizata e Halimit mori fonde nga dy OJQ të Lindjes së Mesme: Saudi al-Waqf al-Islamiya dhe 'Kuvajtian Revival of Islamic Heritage Society'. Organizata e fundit ka zyra në Afganistan dhe Pakistan që ishin në listën e Komitetit të Sanksioneve 1267 të OKB-së në vitin 2002 për lidhjen e tyre me Al-Kaedën.⁴⁷ Gjithashtu, Halimi është i lidhur edhe me predikues të tjerë selefist-xhihadist nga Ballkani. Guy van Vlierden, një gazetar i specializuar në terrorizëm dhe ekstremizëm, raportoi se Halimi mori pjesë në të paktën dy seminare islamike në Belgjikë, të organizuar nga Islamsko Romani Dawetsko Organizacija, një organizatë rome myslimane, së bashku me Bilal Bosniç, i cili është dënuar nga autoritetet boshnjake për rekrutim të luftëtarëve të huaj terroristë për ISIS-in (Fotografia 20).⁴⁸



Fotografia
20

Një afishe nga një ngjarje në Belgjikë ku morën pjesë Halimi dhe Bosniç në vitin 2013

Prania e Halimit në rrjetet sociale është zvogëluar në dy vitet e fundit. Për shembull, llogaria në Twitter e lidhur me të ishte aktive që nga viti 2013 deri të paktën në korrik të vitit 2019 dhe deri atëherë kishte më shumë se 22,100 postime. Llogaria nuk është më aktive në vjeshtën e vitit 2021, por përmbajtja e saj është e qasshme përmes arkivave të internetit.⁴⁹ Duke shfletuar në mënyrë manuale postimet e tij, SCN-ja zbuloi se shumica e përmbajtjeve ishin fetare dhe politike, por nuk përmbanin urrejtje të qartë ose thirrje për dhunë.

Në Facebook, ekziston një grup i mbyllur i ndërlidhur me Halimin me më shumë se 11,700 anëtarë, administratori i të cilit poston mesatarisht dy herë në ditë. SCN-ja nuk ishte në gjendje të kishte qasje në grupin e mbyllur, por të dhënat e Facebook konfirmojnë se grupi është aktiv. Në YouTube, SCN-ja nuk gjeti një llogari që mund të ndërlidhej me Halimin; megjithatë, hulumtuesit identifikuan dy kanale – 'audionur' dhe 'Audionur Shkurt'⁵⁰ – që mbajnë predikime nga Halimi dhe imamë të tjerë etnik shqiptarë. Ngjashmëria në markën e emrit dhe avatarit sugjeron që llogaritë janë në pronësi të të njëjtit subjekt. Kanalet kanë 19,700 dhe 71,100 abonentë, dhe më shumë se 8.3 milion dhe 59.7 milion shikime, veç e veç. Kanali i parë përmban të paktën 630 video të Halimit, ndërsa i dyti ofron të paktën 500, ndërsa të gjitha janë ngarkuar gjatë nëntë viteve të fundit. Hulumtuesit e SCN-në kryen një përmbledhje të shkurtër të një numri videosh që nxirrin në pah Halimin duke diskutuar tema të ndryshme politike në ligjëratat e tij. Për shembull, një video e kishte në shënjestër liderin e partisë politike shqiptare, Bashkimin Demokratik për Integritet, duke i kritikuar ata për praktika korruptive dhe aktivitete anti-myslimane. Në një video tjetër, ai i quajti sulmet e Kumanovës në vitin 2015 si të inskenuara.⁵¹ Videot mund të konsiderohen të diskutueshme nga disa; megjithatë, ato nuk e arrijnë pragun e përmbajtjes ekstremiste dhe të urrejtjes sipas përkufizimeve dhe metodologjisë së SCN-së. Përkundrazi, disa nga ligjëratat dhe citimet e Halimit janë shpërndarë nga zëra shumë të moderuar. Për shembull, disa ligjëratat të mbajtura nga Halimi janë shpërndarë nga Adem Ramadani, një këngëtar i shquar shqiptar që ka më shumë se 680,000 ndjekës në Facebook.⁵² Rasti kompleks i Bekim Halimit është veçanërisht problematik për shkak të aftësisë së tij për të ndikuar tek ndjekësit për çështje sociale dhe politike. Pavarësisht se nuk është jashtëzakonisht ekstremist në postimet e tij të kufizuara publike, prejardhja, rrjeti dhe aktiviteti ekstremist i Bekir Halimit e bëjnë praninë e tij në internet një rrezik për komunitetet e cenueshme sepse materialet mund të paraqesin një portë për materiale më ekstreme. Privatësia në lidhje me disa prej llogarive të tij në mediat sociale është gjithashtu një shenjë shqetësimi se përmbajtja e postuar në ato profile mund të jetë më ekstremiste.

Një tjetër imam me një prani të dukshme në rrjetet sociale është Sadulla (Sadullah) Bajrami. I lindur në Kumanovë dhe i shkolluar në Egjipt, ai dyshohet se ka lidhje me ekstremistët islamik. Një raport i Ekipit të Mbështetjes Analitike dhe Monitorimit të Sanksioneve, i hartuar në përputhje me Rezolutën 2368 (2017) të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, e paraqet Bajramin të ketë pasur lidhje të forta me Al-Kaedën.⁵³ Për më tepër, Bajrami është i lidhur me organizatën islame Thirrja Islame e cila ka qenë veçanërisht aktive në zonën e Shkupit. Puna e tyre përfshin kontakt me të rinjtë që kërkon të edukojë gjimnazistët për mënyrat e duhura për t'u lutur dhe t'i shkurajojë ata të festojnë natën e Vitit të Ri.⁵⁴ Në qershor të vitit 2020, Bajrami regjistroi një grup fetar të quajtur Bashkësia e Ehli Sunetit dhe Xhematit, me seli në Kumanovë, i cili vepron në mënyrë të pavarur nga Bashkësia Fetare Islame.⁵⁵ Sadulla Bajrami ka një prani aktive dhe të fuqishme në internet në shumë kanale të mediave sociale (Fotografia 21). Në Facebook, ekziston një faqe publike e ndërlidhur me Bajramin e cila ka më shumë se 60,100 pëlqime me përmbajtje të reja të publikuara çdo ditë, duke përfshirë video, fotografi dhe përditësime të statuseve.⁵⁶ Kanali përkatës në YouTube kishte më shumë se 2800 abonentë dhe 174 video në vjeshtën e vitit 2021.⁵⁷ Nëpërmjet një mostre të rastësishme të postimeve në të dy llogaritë në mediat sociale, SCN-ja nuk ishte në gjendje të identifikonte përmbajtje që ishte e ndërlidhur me organizata terroriste ose që në mënyrë të qartë bënin thirrje për dhunë, por gjeti postime që paraqisnin interpretime konservatore të Islamit. Përmbajtja e Bajramit ishte e dukshme edhe në faqet tjera në Facebook. Për shembull, menaxherët e mediave sociale të Thirrjes Islame (në Facebook, YouTube, Telegram, Twitter dhe Instagram) postojnë rregullisht përmbajtje të lidhura me imamin.⁵⁸ Bajrami ka shkuar një hap më larg se imamët e përmendur më sipër dhe ka krijuar një kanal fetar digjital në gjuhën shqipe që transmeton përmbajtje rreth Islamit 24 orë, 7 ditë në javë.⁵⁹ Bajrami paraqet një grup të veçantë sfidash për shkak të përpjekjeve të tij për të legjitimuar aktivitetet e tij nën ombrellën e një grupi fetar të njohur nga shteti dhe përpjekjeve të tij për të zgjeruar praninë e tij në mediat në internet në mënyra novatore dhe me përmbajtje në dukje të moderuar.





Fotografia
21

Një fotografi (screenshot) e kanalit digjital të Sadullait në internet

Grupet që postojnë përmbajtje të ISIS

SCN-ja identifikoi përmbajtje eksplicite të lidhura me ISIS-in në Facebook dhe Telegram. Përmbajtja ekstremiste në Facebook zakonisht postohet përmes profileve publike, gjë që e bën të grumbullimin e automatizuar të vështirë për shkak të rregulloreve të privatësisë së platformës.⁶⁰ Megjithatë, duke qenë se materiali me implikime rajonale dhe globale u shpërnda në gjuhën shqipe dhe ishte i qasshëm për shqipfolësit në Maqedoninë e Veriut, ai ishte i rëndësishëm për këtë studim.

Duke shfletuar profilet në Facebook, SCN-ja identifikoi dy grupe ekstremiste në gjuhën shqipe. Një nga grupet ishte Bejtul Muhaxhirin (Shtëpia e migrantëve/refugjatëve), të cilin SCN-ja e kishte hasur më parë në rrjetin e ngarkimit Fuouaris të ISIS-it në Facebook.⁶¹ Megjithëse grupi ka faqen e tij të fansave publik në Facebook⁶² me 597 pëlqime, disa nga përmbajtjet e tij u shpërndanë përmes llogarive të ndryshme private. Për shembull, SCN-ja zbuloi një llogari e cila ishte krijuar për të ndarë publikisht vetëm videot e branduara të Bejtul Muhaxhirin me vegëzë të ISIS-it, duke përfshirë një dokumentar të quajtur Fillimi dhe Fundi (Fotografia 22). Një profil tjetër, i cili ishte shumë më aktiv publikisht, shpërndante përditësimet të statuseve, fotografive, videove, madje edhe dokumenteve të ngarkuara përmes Google Drive (Fotografia 23).




Gjithashtu, grupi kishte prani të konsiderueshme në platforma të tjera, veçanërisht në Telegram (fotografitë 24 deri 26). Chatroom-i i Telegram Bejtul Muhaxhirin është shpërndarë gjerësisht në postimet në Facebook në lidhje me grupin. SCN-ja hyri në kanalin publik Telegram me 861 abonentë në vjeshtën e vitit 2021, e cila postonte çdo ditë. Shumë prej mesazheve i përcilleshin kanalit nga një kanal tjetër privat i mbyllur për publikun.



Fotografia 24

Një 'screenshot' i ekranit nga grupi në Telegram B. Muhaxhirin me një foto ku thuhet: "Media është gjysma e xhihadit".



Fotografia 25


Një 'screenshot' i ekranit nga grupi në Telegram i B. Muhaxhirin që tregon se ekziston një kanal paralel privat i B. Muhaxhirin.



Fotografia 26

Një 'screenshot' i grupit në Telegram i B. Muhaxhirin në media të synuar drejt hipokritëve që ia kthejnë shpinën shariatit. Flamuri i zi në krye është një simbol i përdorur nga B. Muhaxhirin.


Për më tepër, SCN-ja zbuloi se faqja e Bejtul Muhaxhirin në Facebook po shpërndante një lidhje me një kanal në TamTam, një platformë ruse për mesazhe, në të cilën hulumtuesit nuk ishin në gjendje të hynin sepse ose ishin hequr ose ishin vendosur në privat. Më në fund, SCN-ja gjeti një faqe të tërë arkivi të Bejtul Muhaxhirin me 46 ngarkime: 32 dokumente, 13 video dhe 1 skedar audio (Fotografia 27). Materiali në gjuhën shqipe përfshinte biografi, tekste dhe ligjerata nga xhihadistë të njohur Selefi, si Anwar al-Awlaki, Nasir al-Fahd, Ahmad Musa Jibril, Faris al-Zahrani dhe Turki al-Binali. Al-Awlaki dhe al-Binali u vranë nga sulmet ajrore me dronë, ndërsa al-Fahd aktualisht ndodhet në një burg saudit sepse mbështeste sulmet në ShBA.



Fotografia 27

Një 'screenshot' i faqes së arkivit me përmbajtje ekstremiste të Bejtul Muhaxhirin.

SCN-ja identifikoi përmbajtje të tjera Selefiste-xihadiste në internet, në Facebook dhe Telegram. Në telegram, hulumtuesit gjetën një kanal tjetër në gjuhën shqipe të ndërlidhur me ISIS-in, ku shumë llahije (himne myslimane) së bashku me materiale, fotografi dhe video u shpërndanë me 320 abonentë (fotografitë 28 deri në 30). Kanali përmban një sasi të konsiderueshme materiale të ISIS-it, disa prej tyre të përcjella nga një kanal tjetër i Telegramit i titulluar Margaritarë të urtësisë, i cili ka përmbajtje të ngjashme të lidhura me ISIS-in për 418 abonentë. Është interesante të theksohet se kanali Telegram përmbante një video ku shfaqet Sadullah Bajrami në të cilën ai diskreditohej si një imam jo besnik ndaj besimit të tij. Kjo mund të tregojë se brenda komunitetit Selefî-xihadist shqiptar ka konflikte dhe mosmarrëveshje të brendshme.




Fotografia 28

Një 'screenshot' i ekranit nga grupi Nasheedi im Telegram që përmban një video të shkurtër me flamurin dhe tekstin e ISIS-t ku thuhet: "Kur të quajnë terrorist, kjo është dëshmi se je këmbëngulës në besim".



Fotografia 29


Një 'screenshot' i ekranit të grupit Nasheedi im Telegram që përmban një video të shkurtër që diskrediton Sadulla Bajramin si një imam jo besnik ndaj besimit të tij.



Fotografia 30


Një 'screenshot' i grupit Margaritarë të Urtësisë në Telegram që shpërndan postime nga Nasheedi im.

Në Facebook, SCN-ja identifikoi më shumë se dhjetëra llogari personale që përdornin gjuhën shqipe me përmbajtje që sugjeronte mbështetje dhe/ose lidhje me komunitetin selefist-xihadist. Është përtej qëllimit të këtij punimi për të hartuar një rrjet të këtyre llogarive; megjithatë, fotografitë 31 deri në 33 tregojnë shembuj të llojit të profileve që ndërlidhen me disa nga individët dhe grupet e përmendura më sipër.




Fotografia 31

Pamja e ekranit nga një llogari në Facebook me imazhe të ISIS duke përfshirë logon e Nasheedi im në fotografitë e ngarkuara.



Fotografia 32

Pamje nga një llogari në Facebook me një foto të Memishit dhe imamëve të tjerë të burgosur shqiptarë, ku thuhet: "Kanceri nuk mund të shërohet duke i burgosur mjekët".




Fotografia 33

Pamje nga një llogari në Facebook me imazhe të ISIS duke përfshirë një postim me markën Thirrja Islame.

Vëllazëria e krishterë

Megjithëse pjesa dërmuese e përmbajtjes ekstremiste të frymëzuar nga feja që SCN-ja gjeti në internet ishte e ndërlidhur me grupet selefiste-xhihadiste, është e rëndësishme të theksohet prania e grupit të Vëllazërisë së Krishterë në mediat sociale. Megjithëse e identifikon veten si një organizatë apolitike, humanitare, patriotike dhe fetare, ai është, në thelb, një grup etno-nacionalist që bazohet në identitetin e krishterë ortodoks si një nga identifikuesit kyç “brenda grupit”. Prania publike e grupit në mediat sociale është e kufizuar në Facebook dhe YouTube.


Grupi nuk ka reshtur së postuari kërcënime dhe kërkesa përmes kanaleve të tij online. Për shembull, SCN-ja gjurmoi një video famëkeqe live të postuar nga Zharko Grozdanovski, lideri i Vëllazërisë së Krishterë, në të cilën ai kërcënon kryeministrin e Maqedonisë së Veriut me dhunë nëse ai ndjek penalisht një anëtar të grupit (Fotografia 34). Videoja u postua më 29 mars të vitit 2019, por ende është lehtësisht e qasshme në Facebook, ndërsa gjatë dy viteve të fundit ka pasur më shumë se 101,000 shikime. Lideri shpjegon në video se gjoja kishte dy mundësi për të “rregulluar” kryeministrin, por nuk e ka bërë atë sepse është betuar të mos kap armët kundër maqedonasve.



Fotografia 34


Një ‘screenshot’ e një videoje në Facebook ku Zharko Grozdanovski, lideri i Vëllazërisë së Krishterë kërcënon kryeministrin.

Një përmbajtje tjetër në platformën e grupit përfshinte fushatën e Zharko Grozdanovskit për zgjedhjet parlamentare të vitit 2020 si anëtar i Vëllazërisë së Krishterë; pjesëmarrje në protesta antiqeveritare; lëvizje humanitare; takime të Vëllazërisë së Krishterë; përgjigje ndaj çështjeve dhe ngjarjeve politike, e kështu me radhë. Llogaritë gjithashtu kishin shumë postime rreth festimit të festave të krishtera dhe shenjtoreve me çfarë shënohej identiteti i krishterë i grupit, edhe pse shumica e postimeve të tyre politike nuk ishin të ndërlidhura drejtpërdrejt me fenë. Gjatë gjithë hulumtimit, SCN-ja nuk identifikoi ndonjë përmbajtje të postuar në këtë llogari që përdor në mënyrë eksplicite dogmën e krishterë për të nxitur urrejtje dhe thirrje për dhunë. Edhe pse ky grup është kryesisht nacionalist, agjenda e tij politike dhe përdorimi i fesë për të krijuar grupe të “përfshira” dhe “të përjashtuara” është problematike dhe paksa i ngjan taktikës së imamëve ekstremistë selefist-xhihadist të përmendur më lart duke përzier fenë dhe politikën.



Fotografia 35

Një ‘screenshot’ i një videoje në Facebook nga një tubim politik i Vëllazërisë së Krishterë në përgatitje për zgjedhjet parlamentare të vitit 2020.



Fotografia 36



Një ‘screenshot’ i një videoje live në Facebook nga një protestë në mbështetje të “mbrojtësve të kushtetutës” që u burgosën për hyrjen në parlament.

Vëllazëria e krishterë i ka etiketuar dy partitë më të mëdha maqedonase dhe lidhshimin e tyre si tradhtarë për mos mbrojtjen e interesave dhe identitetit të kërcënuar të popullit maqedonas. Prandaj, ata kanë inkurajuar mobilizimin dhe kanë qenë pjesë e protestave antiqeveritare, së fundmi në maj të vitit 2021. Ata kanë kërkuar drejtësi për 'mbrojtësit e kushtetutës' të ndjekur penalisht, të cilët hynë dhunshëm në parlament në vitin 2017 (Fotografia 36). Udhëheqësi i tyre përdori një transmetim të drejtpërdrejtë në Facebook gjatë protestës për të shprehur pikëpamjet dhe kërkesat e tyre. Mbështetja e personave të paditur nga sulmi në parlament në vitin 2017 në internet është shumë problematike dhe indirekt inkurajon akte të dhunës për sa kohë që ato perceptohen legjitime për arritjen e qëllimeve politike. Ky grup ndjek një model të krahasueshëm me grupet e ekstremit të djathtë në ShBA, të cilat kanë mbështetur njerëzit që sulmuan Shtëpinë e Bardhë më 6 janar të vitit 2021. Një fjalor i ngjashëm është përdorur në të dy llogaritë ku 'patriotët' po 'mbronin demokracinë' dhe 'po rikthenin vendin e tyre'.

Përveç mesazheve politike, llogaritë e ndërlidhura me Vëllazërinë e Krishterë kanë reklamuar gjithashtu edhe punën humanitare të grupit (fotografitë 37 dhe 38). Llogaritë e ndërlidhura ose postojnë thirrje për këdo që dëshiron të ndihmojë një person të caktuar në nevojë ose shpërndajnë disa nga përpjekjet e vazhdueshme humanitare të grupit. Fushatat humanitare shfrytëzohen nga Vëllazëria e Krishterë dhe grupe të tjera të së djathtës ekstreme, për të hedhur poshtë çdo pretendim kundër tyre se ata janë një organizatë e dhunshme dhe për të forcuar besueshmërinë e tyre.



Anëtarët e Vëllazërisë së Krishterë kanë përforsuar gjithashtu teoritë e konspiracionit rreth Covid-19. Një vit pas pandemisë, udhëheqësi ende po poston se virusi “ekziston vetëm në kokat tuaja” (Fotografia 39). Për më tepër, profile të tjera të ndërlidhura me Vëllazërinë e Krishterë kanë inkurajuar njerëzit të vizitojnë kishat gjatë festave fetare në periudhën e kufizimeve të shtuara të qeverisë (Fotografia 40).



PËRFUNDIMI

Ky studim shqyrtoi tre nënkategori të materialit polarizues, ekstremist, të mbushur me urrejtje, të cilat kishin në fokus polarizimin politik, urrejtjen etnike dhe ekstremizmin e frymëzuar nga feja. Përmbajtja në maqedonisht dhe shqip u rishqyrta për të fituar një pasqyrë të plotë të narrativeve ekstremiste në internet që kanë të bëjnë me Maqedoninë e Veriut.

SCN-ja identifikoi më shumë se 20,000 komente ekstremiste që mund të klasifikohen si urrejtje politike dhe/ose etnike. Hulumtimi theksoi ekzistencën e një komuniteti digjital thellësisht të ndarë në Maqedoninë e Veriut. Pjesa më e madhe e gjuhës së urrejtjes iu drejtua dy grupeve të njerëzve, “Severxhanëve” dhe “Laramanëve”, të cilët konsiderohen tradhtarë për rolin e tyre në mbështetjen e Marrëveshjes së Prespës dhe përmbysjen e qeverisë së mëparshme, e cila konsiderohet të ketë pasur një qëndrim më të fortë për mbrojtjen e “shtetit maqedonas”. Pasojat e këtij polarizimi kanë çuar në formimin e lëvizjeve nacionaliste të së djathtës ekstreme, të cilat kanë nxitur urrejtje dhe mosbesim shtesë në Maqedoni gjë që përfundimisht mund të shpie në dhunë më të madhe.

Në lidhje me ekstremizmin e frymëzuar nga feja, SCN-ja identifikoi të dhëna që nuk mund të grumbulloheshin në mënyrë automatike. Duke parë përmbajtjen selefiste-xihadiste të lidhur me organizatat terroriste, hulumtuesit kanë zbuluar se imamët radikalë të ndërlidhur me ISIS-in dhe Al-Kaedën janë aktiv në platformat e mediave sociale dhe postojnë përmbajtje që në sipërfaqe duken të moderuara. Gjithashtu, SCN-ja ka identifikuar më shumë grupe ekstremiste të hapura që veprojnë në Facebook dhe Telegram, duke postuar përmbajtje të ndërlidhura me ISIS-in dhe duke bërë thirrje për dhunë. Përveç përmbajtjes selefiste-xihadiste, SCN-ja vlerësoi edhe përmbajtjen e lidhur me grupin etno-nacionalist të krishterë maqedonas. Edhe pse ky grup nuk përdor tekste të krishtera për të bërë thirrje për dhunë, ai ‘turbullon’ kufijtë midis politikës dhe fesë.

Gjetjet dhe rekomandimet e hulumtimit të realizuar nga SCN-ja vijnë në një moment të rëndësishëm për Maqedoninë e Veriut pas rezultateve të zgjedhjeve vendore të tetorit të vitit 2021.⁶² Gjetjet e këtij raporti mund të jenë të dobishme për sektorin e sigurisë në gjurmimin e përmbajtjeve ekstremiste në internet dhe në të njëjtën kohë të mbështesin institucionet që synojnë të forcojnë kohezionin social, duke synuar segmente të cenushme në internet. Për më tepër, gjetjet e hulumtimit ofrojnë një pikënisje për hulumtime në Maqedoninë e Veriut që kanë për qëllim të kuptojnë përmbajtjet ekstremiste dhe urrejtëse në internet.

FUSNOTA

¹ Misha Popovikj, BIRN Skopje (2021), Education Holds Key to Bridging North Macedonia's Ethnic Divide, 10 September, <https://balkaninsight.com/2021/09/10/education-holds-key-to-bridging-north-macedonias-ethnic-divide/>

² Për rekomandime të ngjashme në këtë temë, shih: https://resolvenet.org/system/files/2020-07/RSVE_PolicyNote_WB_ComerfordDukic_July2020.pdf

³ Nën regjimin komunist të Enver Hoxhës, Shqipëria u shpall "shteti i parë ateist", ndërsa Jugosllavia ndoqi një politikë "ateizmi shtetëror".

⁴ Nieves Zúñiga, Transparency International (2020), Examining State Capture: Undue Influence on Law-Making and the Judiciary in the Western Balkans and Turkey, <https://www.transparency.org/en/publications/examining-state-capture>

⁵ Alliance to Counter Crime Online, The Crime and Terror Threat on Social Media, <https://www.counteringcrime.org/crime-and-terror-threat-on-social-media-fact-sheet>

⁶ The World Bank (2020), North Macedonia Overview, <https://data.worldbank.org/indicator/IT.NET.USER.ZS?locations=MK>

⁷ Milo Comeford, Simeon Dukic, Resolve Network (2020), Online Extremism Challenges and Opportunities in the Western Balkans, https://www.resolvenet.org/system/files/2020-07/RSVE_PolicyNote_WB_ComerfordDukic_July2020.pdf

⁸ Të dhënat u grumbulluan nga 26 marsi deri më 23 qershor 2020.

⁹ Ky raport grumbulloi dhe analizoi të dhëna nga 89 grupe dhe faqe të disponueshme publikisht. Të dhënat u grumbulluan nga 30 janari 2019 deri më 6 shkurt 2020.

¹⁰ Ky raport grumbulloi dhe analizoi të dhëna nga 13 kanale me qindra video. Të dhënat u grumbulluan nga 8 janari 2019 deri më 9 janar 2020.

¹¹ Ky raport grumbulloi dhe analizoi të dhëna nga pesë forume. Të dhënat u grumbulluan nga 12 korriku 2002 deri më 1 dhjetor 2019; megjithatë, të dhënat e përdorura ishin nga 1 janari 2019.

¹² Ky raport grumbulloi dhe analizoi të dhëna nga 74 burime të mediave kombëtare.

¹³ Filip Stojanovski, Media Factchecking Service (2014), Hate Speech is Considered a Crime in the Republic of Macedonia, 6 mars, <http://factchecking.mk/hate-speech-is-considered-a-crime-in-the-republic-of-macedonia/>

¹⁴ Qëndresa Sulejmani, Analytica MK Policy report, Politicization in the Macedonian Public Administration, <https://core.ac.uk/download/pdf/33449346.pdf>

¹⁵ Semra Musai, BIRN Macedonia (2016), Macedonia Braces For a Dirty Election Campaign, 22 nëntor, <https://balkaninsight.com/2016/11/22/macedonia-braces-for-a-dirty-election-campaign-11-21-2016/>

¹⁶ RFE/RL Balkan Service (2019), North Macedonia's New President Calls For 'Reconciliation' During Inauguration Ceremony, 12 maj, <https://www.rferl.org/a/north-macedonia-s-new-president-calls-for-reconciliation-during-inauguration-ceremony/29936082.html>

¹⁷ Maarten Lemstra, Clingendael (2020), The Destructive Effects of State Policy Brief Capture in the Western Balkans EU Enlargement Undermined, shtator, https://www.clingendael.org/sites/default/files/2020-09/Policy_brief_Undermining_EU_enlargement_Western_Balkans_September_2020.pdf

¹⁸ Sibel Amet, Helsinki Committee for Human Rights of the Republic of Macedonia (2018), The Rights of Refugees, Migrants and Asylum Seekers in the Republic of Macedonia, <https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2019/05/Help-On-Route-ANG-2018-final.pdf>

¹⁹ Fedja Grulovic, Kole Casule, Reuters (2019), North Macedonia Hosts its First Gay Pride March, 29 qershor, <https://www.reuters.com/article/us-gay-pride-north-macedonia-idUSKCN1TU0JJ>

²⁰ Ivan Damjanovski, IDSCS/Konrad Adenauer Stiftung (2021), Analysis of Public Opinion on North Macedonia's Accession to the European Union (2014–2020), https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2021/02/A5_Analysis-of-public-opinion-on-North-Macedonias-accession-to-the-European-Union-2014-2020ENG.pdf

²¹ 360 Stepeni (2020), Apasiev i ftuar në Prokurori, është hapur proces për statuset e tij në Facebook, 17 korrik, <https://360stepeni.mk/apasiev-povikan-vo-obvinitelstvoto-otvoren-predmet-za-negovite-fejsbuk-statusi/>

²² Shkurtesat në tabelë i referohen: VMRO – Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase; VMRO-DPMNE – Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Bashkim Kombëtar Maqedonas; BDI – Bashkimi Demokratik për Integritim; SDS (LSDM) – Lidhja Social Demokratike (Lidhja Social Demokratike e Maqedonisë).

- ²³ Sinisa Jakov Marusic, BalkanInsight (2011), Macedonia–Greece Name Dispute: What’s in a Name, 30 qershor, <https://balkaninsight.com/2011/06/30/background-what-s-in-a-name/>
- ²⁴ Hellenic Republic, Ministry of Foreign Affairs (2021), The Issue of the Name of North Macedonia, 2 nëntor, <https://www.mfa.gr/en/the-question-of-the-name-of-the-republic-of-north/>
- ²⁵ Republic of North Macedonia, Ministry of Foreign Affairs (2020), Name Issue, 23 nëntor, <https://www.mfa.gov.mk/en/page/1504/name-issue>
- ²⁶ BBC News (2018), Macedonia and Greece: Deal after 27-year Row Over a Name, 12 qershor, <https://www.bbc.co.uk/news/world-europe-44401643>
- ²⁷ Frosina Dimevska, RFE/RL (2019), Termini ‘severxhan’ për ndasi plotësuese, 13 qershor, <https://www.slobodnaevropa.mk/a/%D1%82%D0%B5%D1%80%D0%BC%D0%B8%D0%BD%D0%BE%D1%82-%D1%81%D0%B5%D0%B2%D0%B5%D1%80%D1%9F%D0%B0%D0%BD-%D0%B7%D0%B0-%D0%B4%D0%BE%D0%BF%D0%BE%D0%BB%D0%BD%D0%B8%D1%82%D0%B5%D0%BB%D0%BD%D0%B8-%D0%BF%D0%BE%D0%B4%D0%B5%D0%BB%D0%B1%D0%B8-/29984755.html>
- ²⁸ Joanna Berendt, New York Times (2015), Macedonia Government Is Blamed for Wiretapping Scandal, <https://www.nytimes.com/2015/06/22/world/europe/macedonia-government-is-blamed-for-wiretapping-scandal.html>
- ²⁹ Zoran Arbutina, DW (2017), Kush i frikësohet Sorosit?, 13 qershor, <https://www.dw.com/mk/%D0%BA%D0%BE%D1%98-%D1%81%D0%B5-%D0%BF%D0%BB%D0%B0%D1%88%D0%B8-%D0%BE%D0%B4-%D1%81%D0%BE%D1%80%D0%BE%D1%81/a-39067284>
- ³⁰ Minoritetet në rrezik (2010), Një kronologji për shqiptarët dhe maqedonasit, 16 korrik, <http://www.mar.umd.edu/chronology.asp?groupid=34301>
- ³¹ Bill Hayton, BBC News (2002), Macedonia’s Year of Peace, 3 gusht, <http://news.bbc.co.uk/1/hi/world/europe/2191418.stm>
- ³² Strasko Stojanovski, University of Stip E-prints, Gjuha e urrejtjes në internet dhe rrjetet sociale, <https://eprints.ugd.edu.mk/18475/1/Govor%20na%20omraza%203.pdf>
- ³³ Katerina Blazevska, DW (2020), Софија бара реакција против ‘групата за плукање’, 27 nëntor, <https://www.dw.com/mk/%D1%81%D0%BE%D1%84%D0%B8%D1%98%D0%B0-%D0%B1%D0%B0%D1%80%D0%B0-%D1%80%D0%B5%D0%B0%D0%BA%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0-%D0%BF%D1%80%D0%BE%D1%82%D0%B8%D0%B2-%D0%B3%D1%80%D1%83%D0%BF%D0%B0%D1%82%D0%B0-%D0%B7%D0%B0-%D0%BF%D0%BB%D1%83%D0%BA%D0%B0%D1%9A%D0%B5/a-55744254>
- ³⁴ Numri i herëve që është përdorur fraza “Të rikthejmë vendin tonë” paraqitet në Tabelën 2. #Federalizim u identifikua në grupin politik dhe u paraqit në fotografinë 2.
- ³⁵ Sveto Toevski, Respublika (2019), Двојазичноста вообличува две ‘зони на лингвистичката територијалност’ во Македонија, 15 maj, <https://respublica.edu.mk/mk/blog/2019-05-15-07-49-03>
- ³⁶ Goran Sekulovski, Eurostudia – Revue Transatlantique De Recherche Sur L’Europe (2019), Between the Cross and the Crescent: Marking One’s Territory and Intercultural Coexistence in Orthodox–Muslim Relations in Macedonia, 17 shtator, <https://core.ac.uk/download/188203316.pdf>
- ³⁷ Gjatë kësaj periudhe nën një regjim komunist, politikat laike që promovonin sekularizmin ishin kryesisht aktuale.
- ³⁸ Otmar Oehring, Konrad Adenauer Stiftung (2021), Is the Dispute between the Macedonian Orthodox Church and the Serbian Orthodox Church a Burden on North Macedonia? Shkurt, 2021, <https://www.kas.de/documents/252038/11055681/Dispute+between+the+Macedonian+Orthodox+Church+and+the+Serbian+Orthodox+Church.pdf/9ccbfe9c-be06-d5e2-8525-2e368392cc56?version=1.0&t=1612446156571>
- ³⁹ Nenad Taneski, Ferdinand Odjakov, E-prints, Militant Islamism, Domestic Terrorism and Macedonian National Security, <https://eprints.ugd.edu.mk/22005/1/article%20%20Nenad%20Taneski%2C%20Ferdinand%20Od%20C%20BEakov%20final.pdf>
- ⁴⁰ Atanas Panovski, Calhoun: The NPS Institutional Archive (2011), The Spread of Islamic Extremism in the Republic of Macedonia, dhjetor, <https://calhoun.nps.edu/bitstream/handle/10945/10666/11Dec%255FPanovski.pdf?sequence=1&isAllowed=y>; M.V., Akademik (2014), ИВЗ бара помош за контрола на џамии, МВР вели не е надлежна – треба построги закони, согласни се двете страни, 21 gusht, <https://akademik.mk/ivz-bara-pomosh-za-kontrola-na-dhamii-mvr-veli-ne-e-nadlezhna-treba-postrogi-zakoni-soglasni-se-dvete-strani-4/>

⁴¹ Vlado Azinović, Edina Bećirević, Regional Cooperation Council (2017), A Waiting Game: Assessing and Responding to the Threat from Returning Foreign Fighters in the Western Balkans, <https://www.rcc.int/pubs/54/a-waiting-game-assessing-and-responding-to-the-threat-from-returning-foreign-fighters-in-the-western-balkans>

⁴² RFE/RL (2016), US Treasury Sanctions Four Leaders of Al-Nusra Front in Syria, 11 nëntor, <https://www.rferl.org/a/us-treasury-sanctions-four-nusra-front-leaders-in-syria/28109478.html>

⁴³ Serbian Daily 'Politika' (2018), Albanски снајперисти међу џихадистима у Сирији, 24 shtator, <http://www.politika.rs/scc/clanak/411745/Albanski-snajperisti-medu-dzihadistima-u-Siriji#>

⁴⁴ Sitel Television (2016), Седум години затвор за оцата од Тутунсуз џамијата, останатите добија по пет години за регрутирање борци за ИСИЛ, 25 March, <https://sitel.com.mk/sedum-godini-zatvor-za-odzjata-od-tutunsuz-dzhamijata-ostanatite-dobija-po-pet-godini-za>

⁴⁵ Kaltrina Selimi, Filip Stojkovski, Analyticamk, Assessment of Macedonia's Efforts in Countering Violent Extremism, View from Civil Society, https://www.analyticamk.org/images/Files/extremism-en-updated-FINAL-web_ceb98.pdf

⁴⁶ Congressional Bills 111th Congress (2010), US Government Publishing Office, A Bill to Authorize Assistance to Promote Counter-Extremism Efforts in the Balkan Region, and for Other Purposes, 2 mars, <https://www.govinfo.gov/content/pkg/BILLS-111hr4728ih/html/BILLS-111hr4728ih.htm>

⁴⁷ Shih https://www.wikileaks.org/plusd/cables/07SKOPJE695_a.html

⁴⁸ Guy Van Vlierden, Emmejihad (2013), Romani Gypsies Recruiting for Jihad, 11 dhjetor, <https://emmejihad.wordpress.com/2013/12/11/romani-gypsies-recruiting-for-jihad/>

⁴⁹ Shih https://web.archive.org/web/20191025211058if_/https://twitter.com/bekirhalimii (së fundmi e qasur më 3 qershor 2021)

⁵⁰ Shkurt përkthehet 'short' në anglisht nga shqipja. .

⁵¹ Videot mund të gjenden këtu: <https://www.youtube.com/watch?v=VZGce1HREsM&t=130s> dhe <https://www.youtube.com/watch?v=0Ztd060UdZg> (së fundmi e qasur më 14 qershor 2021).

⁵² Shembuj të pastime përfshijnë: <https://www.facebook.com/AdemRamadanifaqjazyrtare/posts/321004992925733>, <https://www.facebook.com/AdemRamadanifaqjazyrtare/posts/352869153072650>, dhe <https://www.facebook.com/AdemRamadanifaqjazyrtare/posts/311577237201842> and https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=4324779890884828&id=169973239698868 (së fundmi janë qasur më 2 korrik 2021).

⁵³ Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara (2020), Iletër e datës 16 korrik 2020 nga Kryetari i Komitetit të Këshillit të Sigurimit në përputhje me rezolutat 1267 (1999), 1989 (2011) dhe 2253 (2015) në lidhje me Shtetin Islamik në Irak dhe Levant (Da'esh), Al-Kaida dhe individë, grupe, ndërmarrje dhe subjekte të ndërlidhura drejtuar Presidentit të Këshillit të Sigurimit, 23 korrik, https://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/s_2020_717.pdf

⁵⁴ Kaltrina Selimi, Filip Stojkovski, Analyticamk (2016), Assessment of Macedonia's Efforts in Countering Violent Extremism, View from Civil Society, https://www.analyticamk.org/images/Files/extremism-en-updated-FINAL-web_ceb98.pdf

⁵⁵ Komisioni për Marrëdhënie ndërmjet Komuniteteve dhe Grupeve Fetare, <https://www.kovz.gov.mk/pocetna/pregled.nspX>

⁵⁶ Shih https://www.facebook.com/SadullahBajramiZyrtare/?ref=page_internal

⁵⁷ Shih https://www.youtube.com/results?search_query=sadullah+bajrami

⁵⁸ Përmajtja e postuar që përfshin Sadulla Bajramin mund të gjendet lehtësisht në mediat e Thirrjes Islame këtu: <https://www.thirrjaislame.com/>

⁵⁹ Kanali mund të gjendet këtu: <https://albmuslim.tv/index>

⁶⁰ kzystojnë dy kufizime të rëndësishme si rezultat i kësaj: SCN-ja duhej të përdorte teknikat e hulumtimit manual, të cilat vetëm gërvishtin sipërfaqen e rrjetit; dhe gjeo-vendndodhja e llogarisë ishte problematike, kështu që është e vështirë të konfirmohet nëse një llogari e caktuar kontrollohej nga një shtetas dhe/ose një banor i Maqedonisë së Veriut.

⁶¹ Moustafa Ayad, SCN Briefings (2020), The Propaganda Pipeline: The ISIS Fuouaris Upload Network on Facebook, 13 korrik, <https://www.SCNGlobal.org/wp-content/uploads/2020/07/The-Propaganda-Pipeline-1.pdf>

⁶² Shih <https://www.facebook.com/BejtulMuhaxhirin/>

⁶³ RFE/RL's Balkan service (2021), Serbia, North Macedonia, Albania Push Forward on 'Open Balkans' Initiative, 29 July, <https://www.rferl.org/a/serbia-macedonia-open-balkans/31384360.html>

